



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 706 Akti

Nr. 691 Vendimi

Tiranë, më 27.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 25.7.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Merita Selimi**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, me detyrë prokurore në

Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 25.7.2023, kërkoi konfirmimin në detyrë.

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e prokurores në ish-Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë (aktualisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier). Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.12.2020 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Në datën 18.1.2021 është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike të datës 19.1.2021 ka shprehur mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.

5. Në datën 6.7.2023, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Merita Selimi, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendimet e saj brenda 14 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, si dhe për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 7.7.2023, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 20.7.2023.

7. Subjekti i rivlerësimit, në datën 10.7.2023, paraqiti pranë Komisionit kërkesën për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes së hetimit administrativ dhe për tërheqjen e dokumentacionit fizik edhe në formë elektronike, të cilat iu vunë në dispozicion së bashku me rezultatet e hetimit kryesisht. Subjekti paraqiti prapësimet nëpërmjet postës elektronike në datën e caktuar nga

Komisioni, si dhe nëpërmjet shërbimit të postës kanë mbërritur pranë protokollit të institucionit në datën 20.7.2023.

8. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. 3, datë 21.7.2023, vendosi të caktojë seancën dëgjimore në datën 25.7.2023, duke njoftuar subjektin përmes postës elektronike.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Merita Selimi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Merita Selimi. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 25.7.2023 për të rifilluar në datën 27.7.2023 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të këtij ligji. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLP-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit

¹ Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës “Rivlerësimi kryhet nga Komisioni”, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016, “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, me raportin e përgatitur në funksion dhe në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive; (iii) ka mosdeklarime ndër vite; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; (d) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

17. Apartament banimi i ndodhur në lagjen “**”, Lushnjë, në bashkëpronësi**

17.1 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003, si apartament në bashkëpronësi (1/4 pjesë), të përfutur nëpërmjet privatizimit të banesave

shtetërore. Në deklaratën *Vetting* subjekti e ka deklaruar këtë pasuri, me pjesë takuese 1/6 të saj.

17.2 Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, nga ZVRPP (sot ASHK)², por edhe nga kontrolli në sistemin *online* multifunksional të ASHK-së për institucionet, është konfirmuar se znj. Merita Selimi është bashkëpronare³ me 1/6 pjesë të pasurisë në analizë, të llojit apartament me sip. 72 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***, në z.k. ***. Pasuria në analizë është përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., datë 8.7.1993, me palë shitëse Komisioni i Privatizimit Lushnjë dhe palë blerëse M. Q. ⁴, në vlerën 10.330 lekë, sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 7.7.1993.

17.3 Nga FSHU⁵-ja është bërë me dije se me gjeneralitetet Merita Selimi nuk ka rezultuar abonent në Lushnjë, ndërsa UKL⁶-ja ka bërë me dije se nga verifikimi i kryer mbi bashkëpronarët e kësaj pasurie ka rezultuar një kontratë e lidhur nga vëllai i subjektit, z. Q. Q., me adresë lagjja “****”, Lushnjë.

17.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1 të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se nga momenti i emërimit në detyrë si prokurore, nëntor 1992, dhe deri në nëntor të vitit 2003 ka banuar në këtë apartament në lagjen “****”, Bashkia Lushnjë, së bashku me familjen e saj të origjinës.

17.5 Në vlerësim përfundimtar të të gjitha provave dhe rrethanave të evidentuara dhe analizuara më sipër lidhur me pasurinë apartament banimi në lagjen “****”, Lushnjë, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konkludon se subjekti ka kryer një deklaram të saktë në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me saktësinë e deklaramit dhe mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, pasi ajo është përfituar nga privatizimi i banesave shtetërore.

18. Apartament banimi me sipërfaqe 87.44 m², në *, Tiranë**

18.1 Lidhur me këtë apartament subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010 se ka lidhur një kontratë paraprake shitjeje për këtë apartament banimi, të ndodhur në ***, Tiranë, kundrejt çmimit 73.687 euro, ku nga kjo shumë ka deklaruar pagesën e këstit prej 20.000 euro. Për këtë pagesë ajo ka deklaruar burimin e krijimit nga kursimet e 22 viteve punë, si dhe një kredi bankare në shumën 5.000.000 lekë, e palëvruar ende (si burim të ardhshëm për likuidimin total). Më pas, në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e kredisë bankare në shumën 5.000.000 lekë dhe vlerën e paguar prej 53.687 euro.

18.2 Më tej, në deklaratën *Vetting*, ajo ka deklaruar pasurinë nr. ***, z. k. ***, me sipërfaqe 87.44 m², në ***, Tiranë, të blerë me kursimet 30-vjeçare dhe një pjesë të kredisë prej 5.000.000 lekësh, të marrë në BKT. Bashkëngjitur kësaj deklarate, si dhe së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur dokumentet e pronësisë⁷ së kësaj pasurie, si dhe dokumentacionin shoqërues: (i) kontratë paraprake shitjeje nr. ***, datë 17.12.2010, të lidhur mes subjektit dhe bashkëshortit të saj, në cilësinë e palës blerëse dhe shoqërisë “****”

² Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2016, nga ZVRPP Lushnjë; shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2017 dhe datë 7.3.2018.

³ Regjistruar në emër të shtetasve M. Q., Xh. Q., Merita Qorri, T. Q., Q. Q. dhe A. Q..

⁴ Me kërkesën e shtetasit M. Q., në vitin 2013 është bërë rivlerësimi i kësaj pasurie, në vlerën 3.132.000 lekë, kundrejt pagesës së tatimit prej 19.095 lekësh.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2021.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2022.

⁷ Certifikatë për vërtetim pronësie datë 24.12.2010, në emër të shtetasve A. S. dhe M. S.

sh.p.k., në cilësinë e palës shitëse, në të cilën palët kanë rënë dakord për blerjen e pasurisë në vlerën totale prej 73.687 euro. Nga këto, kësti i parë, në vlerën 22.000 euro, është paguar jashtë zyrës noteriale, ndërsa kësti i dytë prej 51.687 euro do të likuidohet në momentin e marrjes së kredisë bankare në BKT; (ii) mandatarëtimi i datës 17.12.2010, sipas të cilit shtetasi A. S. ka paguar shumën 22.000 euro në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “Likuidim pjesor për blerje apartamenti...”; (iii) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 23.12.2010, të lidhur mes subjektit dhe bashkëshortit të saj e shoqërisë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit në analizë, kundrejt çmimit total prej 73.687 euro, e konvertuar në 10.146.699.9 lekë dhe e likuiduar jashtë zyrës noteriale; (iv) deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.12.2010, të lidhur mes të njëjtave palë të lartpërmendura, në të cilën kanë deklaruar se për apartamentin në fjalë, subjekti ka një detyrim të mbetur 51.687 euro, një pjesë e së cilës do të likuidohet nëpërmjet marrjes së një kredie bankare; (v) kontratë kredie bankare nr. ***, datë 26.2.2011, e lidhur mes BKT-së dhe subjektit të rivlerësimit e bashkëshortit të saj, me anë të së cilës banka i ka akorduar këtyre të fundit një kredi prej 5.000.000 lekësh për blerje shtëpie, me specifikimin se kjo shumë do të transferohet në favor të shoqërisë shitëse “****” sh.p.k.; (vi) mandatpagesë e datës 29.7.2011, nëpërmjet së cilës shtetasi Merita dhe A. S. kanë depozituar në llogarinë e shtetasit H. F. shumën 51.687 euro, me përshkrimin “Derdhje për blerje shtëpie”.

18.3 Ministria e Drejtësisë⁸ ka përcjellë informacionin e veprimeve noteriale të regjistruara në RNSH nga data 1.3.2013 e në vijim, në të cilin nuk kanë rezultuar kontratat e lidhura për këtë pasuri, për sa kohë ato datojnë përpara kësaj periudhe.

18.4 Nga përgjigjja me shkrim e ASHK-së⁹, si dhe nga verifikimi i kryer *online* në sistemin multifunksional për institucionet, është konfirmuar se pasuria në fjalë është në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

18.5 Lidhur me mospërputhjen midis përmbajtjes së kontratës së shitblerjes së datës 23.12.2010, ku përshkruhet se është kryer likuidimi total i çmimit në fjalë dhe përmbajtjes së deklaratës noteriale të nënshkruar në të njëjtën datë mes palëve – në përgjigje të pyetësorit nr. 2 – subjekti ka bërë me dije se ndonëse në kontratë është shënuar se vlera e apartamentit ishte paguar jashtë zyrës noteriale (kjo për efekt të vendosjes së apartamentit si garanci hipotekore për marrjen e kredisë), nga të gjitha dokumentet e tjera që kanë shoqëruar këtë kontratë rezulton se gjatë vitit 2010 është paguar vetëm shuma 22.000 euro dhe mbetej për t’u likuiduar në vijim diferenca prej 51.687 euro.

18.6 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti ka transferuar në llogarinë e shoqërisë shitëse, në datën 25.2.2011 shumën 2.117.300 lekë. Ndonëse kontrata e kredisë është nënshkruar më 26.2.2011, nga lëvizjet e llogarisë bankare ka rezultuar se kredia është disbursuar në datën 26.7.2011 dhe, më pas, është transferuar shuma prej 5.000.000 lekësh nga llogaria e subjektit në favor të shoqërisë shitëse, më 29.7.2011.

18.7 Në vijim ka rezultuar se në të njëjtën datë, 29.7.2011, shoqëria “****” sh.p.k. ia ka rikthyer shumën 5.000.000 lekë subjektit të rivlerësimit në llogarinë bankare të kësaj të fundit me përshkrimin “Kthim shume pasi do të paguhet në euro sot”. Në po këtë datë, 29.7.2011, bashkëshorti i subjektit ka depozituar *cash* në llogarinë në euro të shoqërisë shitëse shumën 51.687 euro, me përshkrimin “Derdhje për blerje shtëpie”, ndërkohë që shuma e rikthyer në

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 5.5.2021.

⁹ Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, me postën elektronike të datës 13.1.2020.

llogari të subjektit prej 5.000.000 lekësh është tërhequr prej saj rreth 1 javë pas kryerjes së kësaj pagese, konkretisht në datën 5.8.2011.

18.8 E pyetur në lidhje me lëvizjet e mësipërme bankare, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimi ka bërë me dije se pagesa e shumës prej 2.117.300 lekësh (si diferencë mes vlerës së mbetur në atë moment prej 51.687 euro dhe kredisë prej 5.000.000 lekësh) ishte e kushtëzuar nga banka për t'u kryer përpara lidhjes së kontratës së kredisë. Duke qenë se me shoqërinë shitëse ishte rënë dakord që vlera e mbetur do të shlyhej njëherazi dhe në monedhën euro, kjo e fundit ia ka kthyer pagesën prej 2.117.300 lekësh, për t'u likuiduar së bashku me shumën e kredisë pas disbursimit.

18.9 Gjithashtu, subjekti ka bërë me dije se, në mirëbesim, bashkëshorti i saj kishte marrë shumën 51.687 euro nga vëllai i saj, ndërkohë që kundërvlehtë në lekë i është dhënë atij disa ditë më pas, në datën 5.8.2011, kur është bërë edhe tërheqja e shumës 5.000.000 lekë nga llogaria. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 26.1.2022, të lëshuar nga z. H. F., ku citohet: *“Në datën 25.2.2011 nga llogaria e znj. Merita Selimi pranë BKT-së kanë kaluar në llogari bankare të “****” sh.p.k. shuma prej 2.117.300 lekësh për pagimin e këstit për blerjen e shtëpisë sipas kontratës së parablerjes datë 17.12.2010. Po në këtë datë, nga administratori i shoqërisë është tërhequr kjo shumë, e cila konfirmohet me dokumentin e lëvizjeve në llogarinë bankare të shoqërisë dhe i është dorëzuar dorazi kësaj shtetaseje. Veprimi i kthimit të shumës prej 2.117.300 lekësh është bërë në sportelin e bankës, pasi kësti i parë ishte paguar në dhjetor 2010 dhe sipas deklaratës noteriale (aneksit të kontratës) shuma e këstit të dytë do të paguhej në momentin e lëvrimit të kredisë”.*

18.10 E pyetur në lidhje me përdorimin e këtij apartamenti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se apartamenti në fjalë ka të instaluar matësin elektrik, por nuk furnizohet me energji elektrike. Subjekti ka paraqitur librezat e ujit dhe energjisë elektrike, nga ku ka rezultuar se nuk ka pasur konsum. Ajo ka shtuar se ky apartament nuk është as i mobiluar.

18.11 Nga FSHU¹⁰-ja është bërë me dije se me gjeneralitetet Merita Selimi ka rezultuar një abonent në instancën Tiranë, me nr. kontrate ***, lidhur në datën 30.7.2013¹¹, ndërsa nga UKT¹²-ja është bërë me dije se në emër të shtetasit A. S. ka rezultuar një kontratë me nr. ***, për një objekt me adresë “****”, për lidhjen e së cilës është dorëzuar kontrata e shitblerjes datë 23.12.2010.

18.12 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në lidhje me marrëdhënie të mundshme shoqërore/familjare apo të çfarëdolloj, përfshirë konfliktin e mundshëm të interesave me pronarët e shoqërisë “****” sh.p.k. (përfshirë administratorin dhe/ose ortakët), si dhe shtetasin H. F., subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur marrëdhënie që mund të cenonin apo ndikonin në asnjë proces, që ka pasur në lidhje me kryerjen e detyrës si prokurore, me shtetasin H. F. apo edhe me shoqërinë tregtare në fjalë. Në mbështetje të deklaramit të saj, subjekti ka paraqitur një vërtetimin nr. *** prot., datë 16.7.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, nga i cili është konfirmuar se shoqëria tregtare “****” sh.p.k. dhe shtetasi H. F. nuk kanë qenë kallëzues, të kallëzuar, të dyshuar, të pandehur apo të dënuar në kallëzime dhe/ose procedime

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 12.5.2021.

¹¹ Në këtë kontratë është pasqyruar shënimi “Lidhje e re në datën 30.7.2013, ndryshuar emri nga Q. S. në Merita Selimi, datë 2.10.2013...”.

¹² Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2021.

penale të regjistruara në këtë Prokurori, të hetuara nga subjekti i rivlerësimit përgjatë ushtrimit të detyrës.

18.13 Gjithashtu, po në pyetësin nr. 2, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2021, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku është bërë me dije se nga verifikimet e kryera në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore pranë kësaj gjykate nuk është shqyrtuar ndonjë çështje penale apo civile, ku palë të kenë qenë shtetasi H. F. apo shoqëria “P***” sh.p.k.

18.14 Në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k., ortakët dhe administratorin e kësaj shoqërie, si dhe shtetasin H. F., Komisioni ka administruar informacionin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë¹³, e cila ka bërë me dije se ata nuk kanë rezultuar të kallëzuar, të dyshuar apo persona nën hetim apo të pandehur, në procedime penale të mosfilluara, pushuara të pezulluara apo të dërguara për gjykim nga kjo Prokurori. Nga SPAK¹⁴-u është bërë me dije se nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të administratorit apo të ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k. (shtetasit H. F. dhe L. F.).

Lidhur me analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë

18.15 Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: (i) kursime nga të ardhurat nga paga në 30 vite; (ii) kredi në shumën 5.000.000 lekë në BKT.

Analizimi i kursimeve nga të ardhurat nga paga në 30 vite

18.16 Në lidhje me kursimet nga pagat, në formën *cash*, deklaratimet e subjektit kanë filluar që në DIPP-në e vitit 2003, në të cilën janë deklaruar kursime në masën 4.000.000 lekë, gjendje *cash* pjesërisht në BKT dhe pjesërisht në përdorim të vëllezërve për kambizëm, me burim nga puna 20-vjeçare. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se në vitin 2003, në një llogari depozite në emër të subjektit të rivlerësimit në BKT, ishin depozituar gjithsej 35.000 USD (nga të cilat 20.000 USD në datën 27.6.2003 dhe 15.000 USD në datën 1.8.2003), të cilat së bashku me interesat e fituara përgjatë kësaj periudhe janë tërhequr prej saj në datën 7.1.2004. Në shpjegimet e dhëna në pyetësin nr. 2, subjekti është shprehur se duke qenë deklarimi i parë, i bërë në muajin qershor 2004, ajo i është referuar gjendjes së disponuar në qershor të vitit 2004, kohë në të cilën ajo i kishte tërhequr nga banka dhe i dispononte kursimet në formën *cash*.

18.17 Në DIPP-të në vijim, nga subjekti janë deklaruar kursimet: (i) në vitin 2005, gjendje *cash* në shtëpi 200.000 lekë; (ii) në vitin 2006, gjendje *cash* në shtëpi 500.000 lekë; (iii) në vitin 2008, *cash* në shtëpi 500.000 lekë nga shitja e automjetit dhe 400.000 lekë *cash* nga paga; (iv) në vitin 2009, *cash* në shtëpi 450.000 lekë; (v) në vitin 2010, *cash* në shtëpi 600.000 lekë dhe *cash* në shtëpi nga mbyllja e depozitave 350.000 lekë; (vi) në vitin 2011, *cash* në shtëpi 600.000 lekë.

Lidhur me analizimin e gjendjes cash deri në muajin korrik 2003, në shumën 4.000.000 lekë

18.18 Me qëllim analizimin e të ardhurave nga paga, Komisioni e ka bazuar analizën në dy periudha, ku fillimisht do të analizojë mundësinë e subjektit të rivlerësimit për krijimin e kursimeve deri në fund të muajit korrik 2003, përpara depozitimit të tyre në BKT. Si burim krijimi, në DIPP-në e vitit përkatës, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga puna 20-vjeçare. Në

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 19.10.2022.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2023.

shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se duke qenë se deri në nëntor 2003 ka jetuar me familjen e saj të origjinës dhe kanë qenë nën një regjim të përbashkët familjar – ajo nuk ka kontribuar në shpenzimet familjare, duke i krijuar mundësinë për të kursyer nga të ardhurat e saj.

18.19 Subjekti ka bërë me dije gjithashtu se përveç të ardhurave nga pagat, ajo gjatë këtyre viteve ka pasur edhe të ardhura nga interesat bankarë. Ajo ka bërë me dije se – siç evidentohet në disa listëpagesa të hershme, të paraqitura prej saj – një pjesë e pagës së saj kalohej direkt nga punëdhënësi në llogari kursimi. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur një vërtetim të datës 21.3.2016, të lëshuar nga Raiffeisen Bank, dega Lushnjë, e cila ka bërë me dije se znj. Merita Qorri figuron të ketë qenë depozituese në Bankën e Kursimeve Lushnjë, vërtetuar nga libri i depozituesve me nr. karteles **, depozitë kjo e mbyllur në datën 17.10.1996.

18.20 Për sa më sipër pretenduar nga subjekti, Komisioni i është drejtuar bankës “Raiffeisen”, duke i kërkuar të dhëna mbi shuma të investuara, interesa të fituara apo shuma të tërhequra nga subjekti i rivlerësimit në Bankën e Kursimeve, dega Lushnjë. Raiffeisen Bank, me anë të shkresës nr. ** prot., datë 14.12.2022, ka bërë me dije se pas verifikimeve të kryera në arkivin e ish-Bankës së Kursimeve, dega Lushnjë, ka rezultuar se znj. Selimi (Qorri) ka pasur një depozitë kursimi me nr. ** dhe se gjendja e kësaj depozite në datën 31.12.1995 ka qenë në masën 4.709 lekë – duke shtuar se nuk ka të dhëna të tjera në lidhje me datën e hapjes së depozitës, shumës me të cilën është hapur apo lëvizjet e kryera në të.

18.21 Komisioni ka kryer analizën financiare, duke konsideruar të ardhurat dhe shpenzimet e të gjithë familjes së origjinës së subjektit, për sa kohë deri në momentin e depozitimit të fondeve në BKT, subjekti ka jetuar me ta. Nga të dhënat e disponuara nga Komisioni ka rezultuar se subjekti dhe prindërit e saj kanë realizuar të ardhura nga paga dhe pensionet, në masën 4.675.070 lekë, si dhe 48.000 lekë nga qiradhënia e një lokali nga vëllai i subjektit, me anë të një kontrate qiraje të datës 6.6.1994. Gjatë hetimit administrativ, për sa është disponuar nga Komisioni, nuk ka rezultuar që anëtarët e tjerë të familjes së subjektit të kishin kryer ndonjë investim/blerje në pasuri të tjera, përgjatë periudhës 1993 – 2003.

18.22 Pas përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për të njëjtën periudhë, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej -1.163.429 lekësh, për investimin në depozitë të vlerës 35.000 USD (ose 3.804.150 lekë), duke mos përfshirë në analizë të ardhura të mundshme përgjatë të njëjtës periudhë të vëllezërve të subjektit, për sa kohë nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion provues për këto të ardhura me arsyetimin se ato janë djegur përgjatë trazirave të vitit 1997, por pa paraqitur ndonjë dokument që të vërtetojë sa më sipër është pretenduar.

Tabela nr. 1 – Analiza e burimeve për krijimin e kursimeve në shumën 4.000.000 lekë

	Me te ardhurat dhe shpenzimet e familjes
Te ardhura nga pagat e subjektit 1993 - 30.7.2003	3,478,452
Te ardhura nga pensionet e prinderve 1993 - 30.7.2003	1,196,618
Te ardhura nga qiradhenia T. Q. 1994-1996	48,000
Shpenzime jetese 1993 - 30.7.2003	(2,082,349)
Depozituar ne BKT 35.000 USD	(3,804,150)
Rezultati në datë 30.7.2003	(1,163,429)

18.23 Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit, ku duket se për krijimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë, në vitin 2003, e të përdorura më tej për pagesat e kësteve të blerjes së apartamentit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -1.163.429 lekësh.

18.24 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës ndër të tjera, ka shpjeguar:

*“[...] Nga dokumentacioni i administruar rezulton tej çdo dyshimi të arsyeshëm se vëllezërit e mi kanë filluar të ushtrojnë aktivitet tregtar, që prej vitit 1991. Në Komision është paraqitur dokumentacioni i regjistrimit si person fizik të vëllait tim T. Q., i cili e ka vazhduar aktivitetin e rrobaqepësit prej vitit 1988 dhe pas vitit 1994 me kohë të pjesshme deri në vitin 2007 në profesionin e rrobaqepësit, si dhe të dhëna që tregojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm ushtrimin e aktivitetit të këmbimit valutor/ose siç quhet ndryshme kambizmit, aktivitet i filluar në fillim të viteve 90. Duhet të sqaroh se dokumentacionet lëshuar nga institucione të ndryshme në lidhje me punësimin si rrobaqepës të vëllait tim janë kontradiktore. Sigurimet Shoqërore Fier konfirmojnë si datë fillimi pranë NRSH 1.10.1990, ndërkohë Sigurimet Shoqërore Lushnjë me shkresën *** konfirmojnë kontributin prej qershorit të vitit 1992 dhe Drejtoria e Tatimeve, dega Fier konfirmon që nuk disponon të dhëna për vitin 1992 për aktivitetin rrobaqepës, çka provon se jam në pamundësi të vërtetoj me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të vëllait [...]. [...] Nuk kam mundur të gjej dokumentacion të plotë provues për shumën e të ardhurave të realizuara prej tyre, por duke pasur parasysh vitet e hershme të ushtrimit të aktivitetit, kohën e ruajtjes së dokumentacionit, si dhe faktin që në vitin 1997 qyteti i Lushnjës ishte një nga më të dëmtuarit nga trazirat e këtij viti, mendoj se Komisioni duhet të vlerësojë se jam në kushtet e pamundësisë objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave prej tyre. Për këtë arsye, Komisioni duhet të vlerësojë në përputhje me nenin 32/2 të ligjit nr. 84/2016 se mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme. [...] Unë i qëndroj shpjegimeve të dhëna që përmbajnë dokumentet sipas përgjigjeve të pyetësorëve të depozituar në Komision, pasi deri në këtë datë nuk kam siguruar ndonjë dokument që i përket periudhave para vitit 2002 [...]*

*Pavarësisht nga sa më sipër, në lidhje me diferencën e konstatuar, Komisioni në këtë pikë duhet të mbajë në vlerësim: (i) ndalesat nga pagat dhe depozitim në librezë kursimi të këtyre ndalesave (qëllimi i vendosjes së gjendjes *cash* në librezë kursimi është vetëm përfitimi i interesave, nuk kam mundur t'i dokumentoj, përveçse me metodën alternative të sipërcituar); (ii) bashkëjetesën time me familjen e origjinës, ku të gjithë anëtarët e familjes kanë qenë në marrëdhënie pune dhe mundësinë e sigurimit të të ardhurave për periudhën që është siguruar gjendja *cash* në shumën 4.000.000 lekë; (iii) ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e kambizmit të vëllezërve, i cili është formalizuar vetëm në vitin 2007, por aktiviteti i filluar menjëherë pas vitit 1990; (iv) periudhën shumë të gjatë, e cila tejkalon afatet e detyrimit të ruajtjes së*

dokumenteve të tilla, deri në 10 vjet; (v) gjendjen e pamundësisë objektive për të disponuar dokumente për këto të ardhura, për shkak edhe të një sërë rrethanash objektive siç janë trazirat e vitit 1997”.

Arsyetimi ligjor i fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

18.25 Shumica e trupit gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyetohet se:

18.26 Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurive, kryerjen e shpenzimeve dhe pagimin e detyrimeve.

18.27 Pretendimi i subjektit se *është në pamundësi të provojë të ardhurat nga vitit 1992, pasi nuk disponon të dhëna për vitin 1992 për aktivitetin rrobaqepës, çka provon se është në pamundësi të vërtetojë me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të vëllait*, nuk qëndron, për aq kohë sa nuk gjen zbatim neni 32, pika 2 për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk i vërtetoi Komisionit se dokumenti, i cili vërteton këto të dhëna, është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër.

18.28 Në përfundim të analizimit të burimit të krijimit nga kursimet familjare për periudhën 1992 – korrik 2003, shumica e trupit gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave nga kursimet familjare nga viti 1992 (vit në të cilin ka filluar detyrën) deri në korrik 2003 (vit në të cilin ka krijuar depozitën prej 35.000 USD në bankë), me një mungesë të burimeve financiare në shumën -1.163.429 lekë, për krijimin e shumës 35.000 USD.

18.29 Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar depozitën bankare të krijuar në vitin 2003, në shumën -1.163.429 lekë, shumë e cila ka shërbyer për pagesat e apartamentit, blerë në vitin 2010 me burim nga kursimet.

Analiza e burimeve të përdorura për pagesën e këstit të parë të apartamentit

18.30 Referuar mandatarkëtimit dhe përmbajtjes së deklaratës noteriale, duket se kësti i parë për blerjen e apartamentit në analizë prej 22.000 euro është paguar prej bashkëshortit të subjektit në datën 17.12.2010. Në DIPP-në e këtij viti, subjekti ka deklaruar burimin nga kursimet e 22 viteve punë (duke përfshirë edhe kursimet e analizuara në vitet 1992 – 2003 të analizuara më lart). Në shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve, ajo ka pohuar se ndonëse nuk është deklaruar qartësisht prej saj, pakësimi, burimi i përdorur për këtë pagesë kanë qenë kursimet e disponuara *cash* prej saj. Po ashtu, në shpjegimet e dhëna nga subjekti pranë ILDKPKI-së, në procesverbalin e datës 21.3.2016, e pyetur nga inspektori për të sqaruar gjendjen *cash* vit pas viti, ajo ka bërë me dije se, përveç shtesave të deklaruara nëpër deklaratat vjetore, ka pakësuar gjendjen *cash*: (i) në vitin 2010, me vlerën 3.000.000 lekë për pagimin e këstit të apartamentit prej 22.000 euro; (ii) në vitin 2011, me vlerën 2.117.300 lekë për pagimin

e kështit të dytë të apartamentit; (iii) në vitin 2012, me vlerën 2.642.700 lekë për depozitim të shumës 3.000.000 lekë në Credins Bank.

18.31 Në vijim të deklarimeve të subjektit mbi gjendjen e disponuar *cash* në banesë – bazuar kjo në kërkesat ligjore mbi mënyrën e deklarimit të saj – duket se në fund të vitit 2009 subjekti i rivlerësimit ka pasur kursime në formën *cash* në masën 6.050.000 lekë. Për krijimin e këtyre kursimeve ka rezultuar pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme financiare, si më sipërtrajtuar, të shumës 4.000.000 lekë në vitin 2003 në shumën -1.163.429 lekë, ndërsa për shtesat e tjera ndër vite, nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për t'i krijuar, por nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash*.

18.32 Duke mos marrë në konsideratë përdorimin e këtyre kursimeve – të përmendura si burim financiar i përdorur për kryerjen e pagesës (kursimet e 22 viteve punë), të padeklaruara si të pakësuara sipas ligjit, por të pohuara pranë ILDKPKI-së, në procesverbalin e datës 21.3.2016 – ato duket se kanë qenë të pamjaftueshme për të përballuar kryerjen e pagesës prej 22.000 euro, e konvertuar kjo në 3.053.820 lekë.

Analiza e burimeve të përdorura për pagimin e kështit të dytë të apartamentit

18.33 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka transferuar në llogarinë e shoqërisë shitëse, në datën 25.2.2011, shumën 2.117.300 lekë. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar kryerjen e pagesës totale të atij viti, prej 53.687 euro, duke saktësuar se një pjesë prej 5.000.000 lekësh buronte nga një kredi bankare, por pa dhënë detaje mbi burimin e diferencës së paguar prej 2.117.300 lekësh.

18.34 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se për këtë shumë ka përdorur kursimet e disponuara *cash* në banesë, deklarim ky i bërë edhe më herët në ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur pranë këtij të fundit, në datën 21.3.2016. Gjatë shpjegimeve të dhëna në këtë procesverbal, ndër të tjera, subjekti është shprehur se gjatë vitit 2011 ajo ka pakësuar kursimet e saj në formën *cash* me shumën 2.117.300 lekë, përdorur për pagesën e kështit të dytë të apartamentit në analizë.

18.35 Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit mbi kursimet e disponuara *cash* në banesë ndër vite, duket se në fund të vitit 2010 – pas pakësimit me shumën 3.000.000 lekë gjatë atij viti dhe shtesës së deklaruar prej 950.000 lekësh – gjendja e tyre do të ishte 4.000.000 lekë.

18.36 Duke mos konsideruar përdorimin e këtyre kursimeve, të padeklaruara si të pakësuara në masën përkatëse, duket se ato kanë qenë të pamjaftueshme për të përballuar kryerjen e pagesës prej 2.117.300 lekësh.

Lidhur me kredinë bankare me kushte lehtësuese nga shteti

18.37 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se gjatë vitit 2011 është marrë një kredi bankare në shumën 5.000.000 lekë nga kredimarrësit Merita Selimi dhe A. Q. e dorëzani A. S..

18.38 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se kjo kredi është marrë në kuadër dhe në zbatim të: ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”, i ndryshuar; VKM-së Nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”; udhëzimit nr. 6257, datë 2.9.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”; udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit

e Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave nr. 10240/1, datë 17.10.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”; marrëveshjes tripalëshe të datës 18.2.2009, si dhe çdo marrëveshje tjetër në lidhje me këtë objekt dhe me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

18.39 Subjekti ka sqaruar nëpërmjet përgjigjeve të këtij pyetësi (nr. 2) se kërkesa për kredi të butë është vlerësuar dhe aprovuar nga dy institucionet, përkatësisht Prokuroria e Përgjithshme dhe BKT-ja, të cilat kishin kompetencën dhe detyrimin që të verifikonin plotësimin ose jo të kriterëve të parashikuara në VKM-në Nr. 600, datë 12.9.2007, përpara se të kalonin kredinë. Në mbështetje të deklaramit të saj, subjekti ka paraqitur kërkesën nr. *** prot., datë 1.7.2010, të Prokurorisë së Përgjithshme, me anë të së cilës iu është bërë thirrje të gjitha prokurorive që brenda datës 10.7.2010 të paraqisnin kërkesën me emrat e prokurorëve që donin të aplikonin për kredi për strehim. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2010, ka përcjellë listën me emrat e 7 prokurorëve, ndërmjet tyre edhe të subjektit Merita Selimi. Bashkëlidhur kësaj shkrese, ndër të tjera, ka rezultuar edhe kërkesa për kredi me kushte të lehtësuara e znj. Merita Selimi, në të cilën ajo ka parashtruar se ushtron detyrën e prokurores nga viti 1992 e në vijim dhe se së bashku me bashkëshortin nuk kishin një banesë në emrin e tyre.

18.40 Referuar pikës 2 të VKM-së Nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë” parashikohet se: *“Të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, të sipërpërmendur, kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës, që, në kuptim të këtij vendimi nënkupton territorin e rrethit, ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën”*. Ndërkohë që apartamenti për të cilin synohej të përdorej kredia nga subjekti ndodhej në Tiranë dhe jo në vendin e ushtrimit të detyrës (Lushnjë), siç përcaktohet sipas VKM-së.

18.41 E pyetur nga Komisioni në lidhje me kërkesën për kredi për blerjen e një apartamenti në një qytet të ndryshëm nga ai ku ka ushtruar detyrën, subjekti, në përgjigje të pyetësit nr. 3, është shprehur se në atë periudhë bashkëshortit iu ofrua një punë pranë një shkolle të mesme private në Tiranë, se ajo ka qenë në pritje të transferimit në Prokurorinë e Rrethit Tiranë, si dhe me qëllim arsimimin e vajzës së tyre në Tiranë. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, por edhe nga ai i paraqitur nga subjekti nuk ka rezultuar ndonjë kërkesë e saj për transferim me detyrë në Tiranë.

18.42 Duket se pretendimi i subjektit se apartamenti do të blihej në Tiranë duke qenë se bashkëshortit të saj i kishin ofruar një punë në këtë qytet, si dhe do të përdorej për shkollimin e vajzës së tyre, nuk qëndron, pasi referuar kuadrit ligjor rregullator të sipërpërkthuar, përfitimi i kësaj kredie realizohej nga subjekti, për shkak të funksionit të saj dhe vetëm brenda territorit të rrethit, ku ushtrohej funksioni i prokurorit prej saj.

18.43 Gjithashtu, ndër kushtet për përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese, sipas VKM-së së sipërcituar, ishte edhe mospasja e likuiditeteve mbi vlerën e kredisë së akorduar, në këtë rast 5.000.000 lekë. Konkretisht, në referim të pikës 6/ç të VKM-së së sipërcituar, subjekteve të përcaktuara në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, u lind e drejta për strehim apo për sipërfaqe shtesë banimi, kur: *“...ç) nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/tes pasuri të luajtshme, mjete*

motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likuiditete, tituj pronësie, përfshi edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim". Ndërkohë që, referuar deklaratën të subjektit në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, shuma e kursimeve *cash* e disponuar nga familja e subjektit, në fund të vitit 2010, ka qenë 4.160.000 lekë, e cila së bashku me gjendjen e likuiditeteve bankare përbën shumën 5.326.871 lekë.

18.44 Në vijim të deklaratimeve të subjektit – për marrjen e shumës 51.687 euro nga vëllai i saj, ndërkohë që kundërvlefata në lekë i është kthyer vëllait të saj disa ditë më pas, më 5.8.2011, kur është bërë edhe tërheqja e shumës prej 5.000.000 lekësh nga llogaria, së bashku me vlerën 2.117.300 lekë (shumë kjo e kthyer *cash* nga shoqëria shitëse tek subjekti për të ndërruar valutën nga lekë në euro) – Komisioni ka administruar nga BKT-ja lëvizjet e llogarive të shoqërisë “****” sh.p.k., për të konfirmuar tërheqjen nga kjo e fundit të shumës 2.117.300 lekë. Nga lëvizjet e llogarisë në fjalë është konstatuar tërheqja *cash* e shumës prej 2.117.300 lekësh, brenda së njëjtës ditë, nga administratori i shoqërisë, z. H. F.

18.45 E pyetur në lidhje me mosdeklarimin e transaksioneve të sipërpërkruara, në përgjigjet e saj të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se këto transaksione nuk kishin efekt, pasi janë mbyllur brenda vitit dhe, për këtë arsye, nuk janë vlerësuar si objekt deklarimi. Gjithashtu, ajo ka sqaruar se meqenëse dhënia dhe marrja e shumave të mësipërme me vëllain e saj ka ndodhur në harkun kohor të pak ditëve, ajo nuk e ka konsideruar si hua, por si një veprim këmbimi valutor, ku pagesa në lekë për blerjen e 51.687 euro është kryer disa ditë më vonë. Në mbështetje të deklaratës së saj, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur një deklaratë të thjeshtë, pa datë, të lëshuar nga vëllai i saj, z. T. Q., në të cilën ai ka bërë me dije se i ka vënë në dispozicion, në datën 29.7.2011, shumën 51.687 euro – të disponuar prej tij si mjet qarkullimi i aktivitetit të këmbimit valutor – z. A. S. dhe se në datën 5.8.2011 znj. Selimi ia ka kthyer kundërvleftën në lekë 7.117.300.

18.46 Nga shqyrtimi i deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2010, në deklaratën *Vetting*, si dhe në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 21.3.2016 – ndonëse është pyetur posaçërisht në këtë të fundit – ajo nuk e ka përmendur në asnjërën prej tyre përdorimin e shumës së marrë (si hua apo si vlerë këmbimi të disponuar paraprakisht dhe në mirëbesim, në raport me derdhjen e shumës përkatëse në lekë) nga fondet e aktivitetit të këmbimit valutor të vëllait të saj. Duket se sa më sipër, është pretenduar prej subjektit për herë të parë vetëm në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

18.47 Megjithatë, duke konsideruar marrëdhënien e posaçme të subjektit me vëllezërit e saj, si dhe faktin se marrëdhënia financiare është realizuar brenda pak ditësh dhe të njëjtë vit, Komisioni me rezervë përfshiu në analizën financiare shumën e marrë prej subjektit nga vëllezërit e saj dhe të përdorur përkohësisht prej saj.

18.48 Në analizë të fakteve të dala nga hetimi, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 i ka kaluar barrën e provës subjektit për të dhënë shpjegime bindëse pasi ka konstatuar: (i) lidhur me likuiditet *cash*, dukej se nuk përputhej mënyra e deklaratimeve të subjektit ndër vite, ku ky likuiditet deklarohet “gjendje” apo “*cash*” në shtëpi, me ato gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe me sqarimet e dhëna gjatë procedurave verifikuese të ILDKPKI-së, ku deklarohen si shtesa apo “kursime”; (ii) dukej se subjekti ka përfutur një kredi të butë jo në përputhje me kriteret e përcaktuara nga VKM-ja Nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin

me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë” – rrethanë kjo që mund të bjerë ndesh me etikën e magjistratit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.49 Lidhur me mënyrën e deklarimit të saj ndër vite, subjekti ka parashtruar se mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes *cash*, e deklaruar pranë ILDKPKI-së më 21.3.2016, ka qenë një pakujdesi dhe nuk ka pasur si qëllim fshehjen e pasurisë apo të burimit të saj.

18.50 Ndërsa lidhur me aplikimin për kredi me kushte lehtësuese për blerjen e një apartamenti në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se zgjedhja e Tiranës për blerjen e banesës përkundrejt qytetit të Lushnjës ishte bërë për shkak se ajo priste të transferohej familjarisht në Tiranë. Ajo ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.7.2023, nga ish-drejtori i burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, z. A. D., në të cilën citohej: *“Në vitin 2009 është paraqitur kërkesë për transferim nga institucioni i Prokurorisë së Rrethit Lushnjë në Prokurorinë e Rrethit Tiranë nga prokurorja Merita Selimi. Në vitin 2013, znj. Selimi i është ofruar mundësia për t’u transferuar pranë Prokurorisë së Rrethit Tiranë, por për arsye familjare në këtë moment ky propozim nuk është pranuar prej saj”*.

18.51 Gjithashtu, ajo ka pretenduar që së bashku me kriteret e përcaktuara në VKM-në Nr. 600, datë 12.9.2007 dhe gamën e përfituesve të saj, duhet të mbahej në konsideratë edhe Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë të Financave nr. 6257, datë 2.9.2008, *“Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”*. Sipas pikës 9 të këtij udhëzimi, *diferenca që rezulton midis vlerës së banesës dhe shumës që krediton banka, paguhet në mënyrë të menjëhershme nga familja*. Pra, në rastin konkret, ashtu siç rezulton edhe nga përllogaritjet e kryera nga Komisioni, vlera e banesës ishte e papaguar përpara se të miratohej kredia (pra në fund të vitit 2010 ishte 7.117.300 lekë). Me qëllim që të përfitohej kredia duhej paguar diferenca midis shumës 7.117.300 lekë, e cila ishte e papaguar, dhe shumës maksimale të kredisë 5.000.000 lekë. Nëse gjendjes *cash* 5.326.871 lekë në fund të vitit 2010 i zbritej shuma 2.117.300 lekë, sipas subjektit do të rezultonte se gjendja *cash* në dispozicion do të ishte më e vogël se 5 milionë lekë, pra 5.326.871 lekë – 2.117.300 lekë = 3.109.571 lekë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

18.52 Shumica e trupit gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratën në seancë dëgjimore – arsyeton se:

Për sa i përket mosdeklarimit të pakësimit të gjendjes cash në deklaratat periodike vjetore

18.53 Komisioni, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit sipas nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, orientohet që për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme në të ardhmen të mos prezumoje përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike.

18.54 Fakti që subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë e qartë në deklarinimin e gjendjes *cash* lidhur me shtesat, pakësimet apo saktësimin e përdorimit të kësaj gjendjeje se për cilën pasuri është përdorur ky *cash* i krijuar, nuk krijon bindjen se subjekti është e sinqertë në deklarinimin e kësaj gjendjeje.

18.55 Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarinimit, në rubrikën përkatëse, faqja nr. 3 e formularit, që i përket pasqyrimit të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për “[...] *ndryshimet, shtesa dhe pakësime nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarinimit” që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]*”. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërmbushja e këtij detyrimi sillte pasoja për subjektet deklaruese. Nga rrethanat dhe faktet e rezultuara nga hetimi administrativ rezultoi se argumentet e subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, bien ndesh me detyrimet e saj për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur, në funksion të vazhdimit të qëndrimit në detyrë, sikurse edhe me detyrimet ligjore të subjektit si funksionar publik/subjekt i ligjit nr. 9049/2003.

18.56 Lidhur me pretendimin e subjektit se [...] *mosdeklarimi i pakësimit të gjendjes cash, e deklaruar pranë ILDKPKI-së në datën 21.3.2016, ka qenë një pakujdesi dhe nuk ka pasur si qëllim fshehjen e pasurisë apo të burimit të saj [...]*, nuk qëndron, pasi nga analizimi i burimit të të ardhurave të ligjshme për krijimin e depozitës së vitit 2003 në shumën 35.000 USD, ajo rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme të krijimit të saj.

18.57 Për këtë arsye, shumica e trupit gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin lidhur me deklarinimin e gjendjes *cash* ndër vite, duke u gjendur në kushte e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me aplikimin dhe përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese për shkak të funksionit

18.58 Shumica e trupit gjykues nënvizon se qëllimi i VKM-së Nr. 600/2007 është lehtësimi i kushteve të punës së funksionarëve të lartë shtetërorë nëpërmjet sigurimit të strehimit pranë vendit të punës. Për këtë qëllim, VKM-ja Nr. 600/2007 parashikon si kushte thelbësore në dhënien e mundësisë për të përfituar nga programet e strehimit mungesën e pasjes në pronësi të pasurive të paluajtshme për strehim apo përgjithësisht mundësi të tjera financiare në formë aktiviteti ekonomik, likuiditete dhe mënyrë jetese që dëshmon për gjendje financiare të konsiderueshme ose që tejkalon kufirin e kredisë në emrin e funksionarit apo të personave të lidhur me të. Këto kushte thelbësore lidhen me elementet kyçe të qëllimit të ndihmës nga ana e buxhetit të shtetit për përfitimin e mundësisë për strehim në vendin e punës, ku ndodhet selia administrative e organit ku një funksionar ushtron detyrën dhe me pamundësi financiare nga ana e funksionarit publik.

18.59 Subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nga viti 1992. Në mungesë të një pasurie të paluajtshme për strehim në qytetin e Lushnjës, duke filluar nga data 29.12.2008 (data e hyrjes në fuqi të VKM-së Nr. 1714) subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtën të kërkojë trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti në qytetin ku ushtronte detyrën, për shkak të ushtrimit të detyrës si prokurore.

18.60 Duke qenë se kredia me kushte lehtësuese: (i) është përfituar në vitin 2011, tërhequr nga subjekti në datën 5.8.2011, kohë kur subjekti ushtronte funksionin e prokurorit në Lushnjë; (ii) pasuria që do të blinte subjekti nuk ndodhej në qytetin e Lushnjës sipas VKM-së, por në qytetin e Tiranës, pra kishte ndryshim destinacioni; (iii) subjekti ka pasur gjendje të likuiditeteve bankare në shumën 5.326.871 lekë, por edhe likuiditete *cash* sipas deklarimeve vjetore, DPV-ve, fakte të cilat bie ndesh me pikën 6/ç të VKM-së së sipërcituar, ku subjekteve, të përcaktuara në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, u lind e drejta për strehim apo për sipërfaqe shtesë banimi, kur “... ç) nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/tes pasuri të luajtshme, mjete motorike për qarkullim në tokë/det/ajër; likuiditete, tituj pronësie, përfshirë edhe të drejta reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim”; (iv) subjekti nuk vërtetoi me dokumentacion ligjor kërkesën për transferim në Tiranë të saj dhe të bashkëshortit – shumica e trupit gjykues vlerëson se këto fakte të çështjes janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarre veprime, të cilat kanë passjellë shmangien e zbatimit të normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare dhe, si të tilla, bien ndesh me etikën e magjistratit, duke i vlerësuar kështu në drejtim të sjelljes së subjektit të rivlerësimit në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

Analiza e burimeve të ligjshme të huadhënësve

18.61 Duke konsideruar periudhën e shkurtër të huadhënies – çka mund të justifikonte pjesërisht mosdeklarimin nga ana e subjektit në DIPP-në e vitit – si dhe mosdokumentimin e kësaj marrëdhënieje, për shkak të marrëdhënies së posaçme, si rrjedhojë e lidhjes së ngushtë familjare me huadhënësin, Komisioni ka vlerësuar edhe variantin e pretenduar nga subjekti. Në këto kushte, duke e konsideruar marrjen e shumës prej 51.687 euro, si një hua të marrë nga bashkëshorti i subjektit prej vëllezërve të kësaj të fundit, ndonëse për një periudhë të shkurtër 1-javore ka hetuar dhe analizuar lidhur me burimet financiare të personave të tretë (në cilësinë e huadhënësve afatshkurtër).

18.62 DRT Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 26.1.2022, ka bërë me dije se shoqëria “****” sh.p.k. është regjistruar pranë kësaj drejtorie në datën 4.7.2007, me aktivitet “këmbim valutor, agjenci udhëtimi dhe informacioni, veprimtari financiare dhe transferim parash në llogari të AK-Invest”. Në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, përlllogaritja dhe mbledhja e detyrimeve të tatim-fitimit të thjeshtuar ka qenë nën administrim të qeverisjes vendore.

18.63 Bashkia Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2022, ka bërë me dije se shoqëria “****” sh.p.k. ka paguar taksat dhe tarifat vendore dhe ka pasqyruar qarkullimet vjetore të deklaruara pranë organeve vendore nga kjo shoqëri për vitet 2008 – 2013, përkatësisht në vlerat: 1.320.405 lekë; 1.134.780 lekë; 1.219.564 lekë; 1.209.685 lekë; 1.046.428 lekë dhe 960.241 lekë.

18.64 Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2021, ka bërë me dije se zyra e këmbimit valutor “****” sh.p.k. në Lushnjë nuk ka dërguar pranë saj raportime për vëllimin e blerjeve dhe shitjeve të valutave për vitin 2011.

18.65 Ndërkohë, subjekti, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, ka paraqitur një dokument të firmosur dhe vulosur nga shoqëria “****” sh.p.k., të titulluar Aneksi 2 “Raportimi ditore i veprimtarisë së këmbimit valutor”, datë 29.7.2011, në të cilin është pasqyruar tek veprimet me individë (me shënimin kunati) blerje valute në shumën 7.386.450 lekë.

18.66 Nga Komisioni është administruar informacioni nga bankat e nivelit të dytë për lëvizjet e llogarive bankare të tyre. Nga këto lëvizje është konstatuar një nivel i konsiderueshëm qarkullimi parash, me qëllim përdorimi këmbimin valutor, nga ku duket se niveli i të ardhurave të deklaruar në organet tatimore, për efekt të tatimit të fitimit, përmban vetëm pjesën e fitimit të kësaj shoqërie nga transaksionet e këmbimit valutor¹⁵. Gjithashtu, nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare dhe nga niveli i parave të qarkulluara prej vëllezërve të subjektit – i cili gjatë vitit 2011 ka qenë së paku rreth 925.000 euro dhe rreth 1.3 milionë euro gjatë vitit 2010 – duket se ata mund të kenë pasur disponibilitet të shumës 51.687 euro, për t’ia huazuar përkohësisht subjektit.

18.67 Nga DPSHTRR-ja, me shkresën nr. *** prot., është bërë me dije se shtetasi T. Q. ka të regjistruar automjetin me targë ***, të blerë pas periudhës së analizuar, si dhe ka pasur të regjistruar një automjet me targë ***, aktualisht të çregjistruar, të blerë në datën 17.5.2005, përpara periudhës së analizuar. Ndërsa për shtetasin F. Q., DPSHTRR-ja ka bërë me dije se nuk ka automjete të regjistruara.

18.68 Komisioni, në analizë të fakteve e rrethanave të dala përgjatë hetimit bazuar në nenin 52 të ligjit, i ka kaluar barrën e provës, pasi ka konstatuar se: (i) dukej se për krijimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë, në vitin 2003, e të përdorura më tej për pagesat e kësteve të blerjes së apartamentit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -1.163.429 lekësh; (ii) dukej se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2010 dhe 2011 pakësimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë, për të mundësuar pagesën e këstit të parë dhe të dytë të apartamentit në analizë; (iii) dukej se brenda të njëjtës datë 23.12.2010, prej subjektit janë nënshkruar dy akte noteriale kontradiktore midis tyre – sa i përket pagesës së çmimit të apartamentit në analizë – nga ku sipas kontratës së shitblerjes shuma prej 73.687 euro është likuiduar nga subjekti totalisht jashtë zyrës noteriale, ndërsa sipas deklaratës noteriale palët kanë deklaruar se kanë një detyrim të mbetur në vlerën 51.687 euro; (iv) dukej se për kryerjen e pagesës së këstit të parë dhe të këstit të dytë të blerjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare nga kursimet e disponuara *cash* në banesë; (v) dukej se ka mospërputhje midis kohës së tërheqjes prej subjektit të shumës së kredisë bankare të marrë me qëllim likuidimin e pjesës së çmimit të blerjes së apartamentit, si dhe kryerjes së pagesës në favor të shoqërisë shitëse, e cila ishte bërë rreth një javë më herët; (vi) dukej se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar/specifikuar marrjen dhe përdorimin e përkohshëm të fondeve prej 51.687 euro nga vëllai i saj, në deklaratën *Vetting* (si burim i përdorur fillimisht në momentin e pagesës, ndonëse për një periudhë të shkurtër njëjavore) – apo përgjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

18.69 Në lidhje me krijimin e kursimeve të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 të gjendjes *cash*, subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizë edhe të të ardhurave të vëllezërve të saj. Ajo ka bërë me dije se vëllezërit e saj kanë ushtruar aktivitetin e këmbimit valutor edhe përpara vitit 2007, periudhë për të cilën ky lloj aktiviteti nuk ka pasur rregullim ligjor dhe fiskal.

¹⁵ VKM-ja Nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”, përcakton se tek të ardhurat përfshihen të ardhurat që realizohen në kuadrin e ushtrimit të veprimtarisë së njësisë ekonomike: nga shitja e produkteve dhe e mallrave, nga kryerja e punimeve dhe shërbimeve, nga interesat dhe dividendët, nga qiratë, honorarët, komisionet, etj.

18.70 Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës: (i) një mandat tërheqjeje të vitit 1998 nga BKT-ja, dega Lushnjë, të shumës 7.5 milionë dhrahmi greke (~ 3 milionë lekë); (ii) tri deklarata noteriale të shtetasve të ndryshëm që kanë deklaruar se kanë ushtruar aktivitetin e këmbimit valutor së bashku me vëllezërit e subjektit edhe përpara vitit 2007.

18.71 Subjekti ka shpjeguar se vëllai i saj ka realizuar të ardhura nga qiraja edhe pas vitit 1996 e gjithashtu ka ushtruar edhe aktivitetin e rrobaqepësit deri në vitin 2007. Subjekti ka pretenduar se është në pamundësi objektive sipas parashikimeve të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 për të gjetur dokumentacionin ligjor përkatës, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe trazirave të vitit 1997.

18.72 Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentacionin, specifikisht: (a) deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.7.2023, nga shtetasi K. I. Në këtë deklaratë, z. I. ka deklaruar se ka marrë me qira lokalin në pronësi të shtetasit T. Q. gjatë periudhës 1996 – 1998, kundrejt pagesës prej 15.000 lekësh në muaj; (b) deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.7.2023, të lidhur me ushtrimin e aktivitetit si rrobaqepës deri në vitin 2007; (c) vërtetimin nga shoqëritë huamarrëse në administrim, ku është bërë me dije se shtetasi Q. Q. ka depozituar shumën prej 500.000 lekësh në shoqërinë rentiere “***” dhe ka tërhequr shumën 645.000 lekë në korrik të vitit 1996.

18.73 Subjekti ka pretenduar se në përlllogaritje duhet të përfshiheshin edhe kursimet e krijuara nga pagat e saj gjatë periudhës përpara vitit 1993, të cilat, ndonëse të ulëta, ajo ka pretenduar se i ka konvertuar në dollarë amerikanë për shkak të kursit të ulët të këmbimit të asaj kohe, duke krijuar kështu kurse prej 4.000 USD.

18.74 Në lidhje me krijimin e shumës 4.000.000 lekë, subjekti ka parashtruar se si burim, përveç të ardhurave të saj nga punësimi, kanë shërbyer edhe të ardhurat nga interesat bankarë. Përqindja e interesave të depozitave ka qenë shumë e lartë sidomos në vitin 1997, përqindja mesatare e depozitave ka arritur deri 27.8%. Nëpërmjet një eksperti ajo ka përlllogaritur në mënyrë alternative interesat nga depozitat, të cilët, në mungesë të dokumentacionit bankar për shkak të kohës së gjatë të kaluar, si dhe në mbështetje të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 duhet të merren në vlerësim nga Komisioni. Eksperti kontabël ka përlllogaritur një kursim në masën 70% dhe për kursimin e realizuar ka përlllogaritur interesat dhe, sipas përlllogaritjeve të kryera, vlera e kursyer + interesat janë përlllogaritur në masën 6.597.561 lekë, referuar të dhënave që përmbajnë raportet vjetore të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësinë e kursimit të shumës 4.000.000 lekë. Nga kjo shumë është depozituar në vitin 2003 shuma prej 35.000 euro.

18.75 Në lidhje me mospërputhjen midis përmbajtjes së kontratës së shitblerjes së datës 23.12.2010, ku përshkruhet se është kryer likuidimi total i çmimit të apartamentit dhe përmbajtjes së deklaratës noteriale të nënshkruar në të njëjtën datë mes palëve, subjekti ka parashtruar se, ndonëse në kontratë është shënuar vlera e apartamentit, ishte paguar jashtë zyrës noteriale (kjo për efekt të vendosjes së apartamentit si garanci hipotekore për marrjen e kredisë). Nga të gjitha dokumentet e tjera që kanë shoqëruar këtë kontratë, rezulton se gjatë vitit 2010 është paguar vetëm shuma 22.000 euro dhe mbetej për t'u likuiduar në vijim diferenca prej 51.687 euro. Pra, në rastin konkret, ka disa dokumente me fuqi të plotë provuese, të cilat shpjegojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm se në dhjetor të vitit 2010 është paguar vetëm shuma 22.000 euro për blerjen/porositjen e këtij apartamenti. Deklarata noteriale e nënshkruar

midis palëve në të njëjtën ditë të nënshkrimit të kontratës, sipas subjektit shuan çdo dyshim të Komisionit se “vlëra e apartamentit është paguar e plotë në vitin 2010”.

18.76 Subjekti ka parashtruar se ka pasur mundësi financiare për të kursyer nga të ardhurat e saj shumën 4.000.000 lekë, si dhe ka pretenduar se: *“Komisioni duhet të mbajë në vlerësim: (i) ndalesat nga pagat dhe depozitimin në librezë kursimi të këtyre ndalesave (qëllimi i vendosjes së gjendjes cash në librezë kursimi është vetëm përfitimi i interesave, nuk kam mundur t'i dokumentoj, përveçse me metodën alternative të sipërcituar); (ii) bashkëjetesën me familjen e origjinës, ku të gjithë anëtarët e familjes kanë qenë në marrëdhënie pune dhe mundësinë e sigurimit të të ardhurave për periudhën që është siguruar gjendja cash në shumën 4.000.000 lekë; (iii) ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e kambizmit të vëllezërve, i cili është formalizuar vetëm në vitin 2007, por aktiviteti i filluar menjëherë pas vitit 1990; (iv) periudhën shumë të gjatë, e cila tejkalon afatet e detyrimit të ruajtjes së dokumenteve të tilla deri në 10 vjet; (v) gjendjen e pamundësisë objektive për të disponuar dokumente për këto të ardhura, për shkak edhe të një sërë rrethanash objektive, siç janë trazirat e vitit 1997”.*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

Lidhur me burimet e ligjshme financiare për krijimin e gjendjes cash deri në vitin 2003

18.77 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit, në raport me faktet e konstatuara, sa i takon pamjaftueshmërisë financiare në shumën -1.163.429 lekë për krijimin e kursimeve të disponuara *cash* në banesë në vitin 2003 e të përdorura më tej për pagesat e kësteve të blerjes së apartamentit në analizë – arsyeton sa vijon:

18.78 Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e mundshme nga punësimi, aktiviteti privat kambizëm dhe qiradhënia përgjatë së njëjtës periudhë të vëllezërve të saj, duke pretenduar pamundësinë sipas rrethanave të përshkruara në qëndrimin e saj, parashtruar më sipër, trupi gjykues lidhur me këtë çështje, në analizë të provave të depozituara dhe rrethanave konkrete të saj, arsyeton duke analizuar veçmas të dyja situatat e pretenduara: (a) provueshmërinë e këtyre të ardhurave në përmbushje të kriterëve ligjorë të kërkuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016; (b) vlerësimin e rrethanave të pamundësisë së subjektit për të provuar këto të ardhura.

18.79 Sa i takon nivelit të provueshmërisë së të ardhurave të pretenduara, trupi gjykues konstaton se dokumentacioni i depozituar nga subjekti për të ardhurat nga aktiviteti i vëllait si rrobaqepës nuk provon masën e këtyre të ardhurave të përfituara, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore. Nga ana tjetër, sikurse është pranuar edhe nga vetë subjekti, dokumentacioni i lëshuar nga Sigurimet Shoqërore Fier dhe Drejtoria e Tatimeve nuk konfirmon pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura; kjo e fundit ka konfirmuar faktin se nuk disponohen të dhëna për vitin 1992 për aktivitetin rrobaqepës të vëllait të saj. Në këto rrethana, trupi gjykues çmon se këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizë financiare.

18.80 Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti i kambizmit, në analizë të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se nga të dhënat e administruara nuk provohen veprimet e këmbimit valutë dhe, sikurse është pranuar edhe nga vetë subjekti, kjo e fundit nuk ka arritur të dokumentojë përfitimin e këtyre. Në këtë drejtim, trupi gjykues vlerëson se deklarata e lëshuar nga individë të ndryshëm gjatë procesit, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, merret me rezervë dhe, në këtë rast, çmohet pa relevancë në çështjen objekt vlerësimi.

18.81 Lidhur me të ardhurat nga qiraja, trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, deklarata noteriale të dy shtetasve që deklarojnë se kanë vazhduar aktivitet të tyre në dyqanin në pronësi të vëllait të saj, konstaton se ato mbeten vetëm në nivel deklarativ dhe në asnjë rast nuk provojnë mënyrën e përfitimit të tyre nga vëllai i subjektit, pra burimin e ligjshmërisë, masën e përfituar dhe pagesën e detyrimeve tatimore e, si të tilla, ato nuk mund të përfshihen në përllogaritjet financiare të kryera.

18.82 Trupi gjykues, konstaton se edhe të ardhurat e përfituara nga interesat bankarë nga depozitat janë në të njëjtin nivel shpjegimesh të subjektit sikurse përgjatë hetimit. Në këtë drejtim rezulton se Raiffeisen Bank¹⁶ ka informuar Komisionin se pas verifikimeve të kryera në arkivin e Bankës së Kursimeve, dega Lushnjë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur një depozitë kursimi, por gjendja e saj në datën 31.12.1995 ka qenë në masën 4.709 lekë dhe nuk ka të dhëna për hapjen e saj e lëvizjet e kryera. Në këto rrethana, trupi gjykues konstaton se vlera e konfirmuar nga banka është në një masë të papërfillshme, si dhe pretendimet e subjektit për këto të ardhura nuk provohen me dokumentacion, pavarësisht pretendimit të subjektit për pamundësinë e saj sipas nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, pretendim ky që do të arsyetohet në vijim.

18.83 Lidhur me pretendimin e subjektit se nga ana e Komisionit në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e saj përpara vitit 1993, për shkak se këtyre kursimeve nuk u ka rënë vlera pasi me rritjen e inflacionit u rrit vlera e shkëmbimit të dollarit në lekë, trupi gjykues, për një vlerësim objektiv, për shkak të pretendimit për të ardhura të një periudhe të hershme, përpara vitit 1993, në raport me pretendimet e subjektit, konstaton se nga të dhënat e publikuara¹⁷ rezulton se pas vitit 1991 ka ndodhur ndryshimi i kursit dhe vlerës së monedhës shqiptare dhe se inflacioni i atyre viteve ishte rreth 15.8%, çka do të thotë se niveli i përgjithshëm i çmimeve të konsumit në ekonomi u rrit me 15.8% në krahasim me vitin e kaluar, situatë kjo që ka vazhduar deri rreth vitit 1998. Në këtë drejtim konstatohet se të ardhurat në këto vite jo vetëm që kanë qenë të një niveli shumë të ulët, porse edhe kursi i këmbimit ka tregues të ulët. Ky fakt, shoqëruar me mosekzistencën e provueshmërisë së masës së përfitimit të tyre, vlerësohet nga trupi gjykues se pretendimi i subjektit për të përfshirë në përllogaritje këto të ardhura nuk gjendet i bazuar dhe logjikisht i arsyeshëm.

18.84 Trupi gjykues çmon se mungesa e provueshmërisë së të ardhurave të pretenduara nga subjekti, nën dritën e rrethanave të analizuara me objektivitet si më lart, nuk konsiderohet se subjekti gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak se nuk rezulton të provohen në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e kësaj dispozite. Në këtë vlerësim, trupi gjykues ka në konsideratë edhe faktin se subjekti ka qenë në detyrë që prej vitit 1992 dhe me këto kursime subjekti krijon pasuri e investime si një nga burimet e krijimit të tyre.

18.85 Trupi gjykues në analizën financiare ka përllogaritur të ardhurat nga punësimi gjatë vitit 1993 të vëllait të subjektit T. Q., në vlerën 10.639 lekë, të cilat pas zbritjes së shpenzimeve të jetesës ndryshojnë rezultatin në – 1.155.982 lekë.

18.86 Në përfundim, lidhur me analizimin e burimit të ligjshëm të shumës 4.000.000 lekë *cash*, deklaruar në vitin 2003, trupi gjykues, për sa më sipër arsyetuar dhe në konsideratë të vlerësimeve të kryera, çmon se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2022.

¹⁷ https://.bankofalbania.org***

(-1.155.982) lekë për krijimin e këtyre kursimeve të përdorura për pagesat e kësteve të blerjes së pasurisë apartament në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatim i cili është vlerësuar në tërësi me rrethanat e çështjes që janë përcaktuese për vlerësimin e kriterit të pasurisë apo procesit të rivlerësimit në tërësi.

Lidhur me deklarin e gjendjes cash në deklarata periodike vjetore

18.87 Në drejtim të pretendimeve të subjektit për përfshirjen në analizën financiare të gjendjes *cash* të disponuar në vitin 2003, Komisioni vëren se nuk mund të përfshijë në analizë financiare gjendjen *cash* në banesë, nëse ato nuk janë deklaruar ndër vite nga subjekti si të tilla. Kjo pasi, sikurse është qartësuar nga jurisprudenca e konsoliduar, gjendja *cash* që rrjedh nga kursime të mundshme vjetore nuk mund të prezumohet duke u bazuar vetëm në marzhet e mundësive financiaro-matematikore, të cilat mund të lënë hapësirë për kursime hipotetike në fund të vitit, por do të duhet të ishin deklaruar ndër vite apo të mund të provohen me mjete alternative plotësuese.

18.88 Lidhur me detyrimin për deklarimin e likuiditeteve *cash*, vlen të përmendet se ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, në nenin 4 parashikonte se: “*Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]*”. Formulari i deklarimit të pasurisë (prej vitit 2004) në faqen 3 ka përkrahur mënyrën se si duhen deklaruar interesat, duke iu referuar nenit 4, shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d” të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003.

Lidhur me vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimit të subjektit të rivlerësimit

18.89 Lidhur me vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimit të subjektit për burimin e ligjshëm të pasurisë apartament, fituar sipas kontratës paraprake të shitjes nr. ***, datë 17.12.2010 dhe kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 23.12.2010, trupi gjykues ka konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, në deklaratën periodike, si dhe përgjatë viteve sipas pretendimit të saj për burimin “hua nga vëllai”.

18.90 Trupi gjykues vlerëson se ekzistojnë një sërë rrethanash që nuk bëjnë të besueshme deklarin e subjektit për vërtetësinë e burimeve të kësaj pasurie dhe destinacionin e tyre. Në këtë drejtim, trupi gjykues ka konstatuar fakte provuese, të tilla:

18.90.1 Rezulton se subjekti brenda së njëjtës datë, 23.12.2010, ka nënshkruar dy akte noteriale kontradiktore midis tyre – sa i përket pagesës së çmimit të apartamentit në analizë.

18.90.2 Rezultojnë mospërputhje midis kohës së tërheqjes prej subjektit të shumës së kredisë bankare të marrë me qëllim likuidimin e pjesshëm të çmimit të blerjes së apartamentit, si dhe kryerjes së pagesës në favor të shoqërisë shitëse, e cila ishte bërë rreth një javë më herët.

18.90.3 Rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar huan e përkohshme që ka pretenduar të marrë nga vëllai i saj si në DPV-të vjetore, ashtu edhe në atë *Vetting*. Ky

mosdeklarim merr peshë në raport me mosdeklarimin e saj përgjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2016, si dhe për faktin se subjekti dispononte likuiditet *cash* në fund të vitit 2010 në shumën 5.326.871 lekë, çka bënte të panevojshme marrjen e kësaj huaje.

18.91 Në këtë drejtim, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, mbajmë në konsideratë se sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Bazuar në këto dispozita ligjore, në raport me rrethanat faktike të çështjes, trupi gjykues konstaton se sipas pretendimit të subjektit do të rezultonte që burimi fundor dhe real i krijimit të kësaj pasurie është huaja e padeklaruar në deklaratën *Vetting*, në deklarata periodike dhe pranë ILDKPKI-së, porse vetëm gjatë hetimit përmes pyetësorëve. Në këtë drejtim, rrethanat faktike dhe konkrete janë vlerësuar nga trupi gjykues, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit si më poshtë arsyetuar.

18.92 Gjatë hetimit nuk provohet destinacioni final i kredisë së marrë nga subjekti në rrethanat konstatuese të deklarimit të saj se një pjesë e kredisë është përdorur për blerje apartamenti dhe një pjesë në investimin e obligacioneve, porse evidentohet një burim i ri i padeklaruar (huaja e vëllait) dhe subjekti karakterizohet nga deklarime të pasakta të likuiditetit *cash* të pranuar edhe nga vetë ajo.

18.93 Pavarësisht pretendimit të subjektit për një marrëdhënie familjare, trupi gjykues në çështjen objekt vlerësimi nuk ka asnjë provë, që mund të identifikonte/provonte faktin e marrjes dhe kthimit të kësaj huaje.

18.94 Trupi gjykues nuk mund të bazohet në nivelin e shpjegimeve të subjektit vetëm përgjatë hetimit dhe në parashtrime, për sa kohë ato nuk vijnë në harmoni me deklaratimet e saj në deklaratën *Vetting*, deklaratat periodike dhe në ILDKPKI, të cilat nuk janë të shoqëruara me deklarime të burimeve në zërin e likuiditeteve dhe mosdeklarime të pakësimit të gjendjes *cash* dhe të tërheqjeve të kryera sipas pretendimeve të saj.

18.95 Trupi gjykues çmon se këto fakte, në harmoni me njëri-tjetrin, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklaratimet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me vërtetësinë e burimeve të kësaj pasurie dhe destinacionin e tyre. Kjo situatë faktike në çmuarjen e trupit gjykues krijon kushtet që kjo problematikë të vlerësohet në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke e kualifikuar si një ndër shkaqet për aplikimin e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

19. Apartament banimi në lagjen “**”, Lushnjë**

19.1 Në DIPP-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi me nr. ****, me sip. 89 m², e ndodhur në lagjen “****”, Lushnjë, në vlerën 3.000.000 lekë, në pronësi të vjehrrit të saj. Më pas, në DIPP-në e vitit 2015, ajo ka deklaruar pasurinë në fjalë në bashkëpronësi të bashkëshortit dhe nënës së tij, në masën ½ pjesë secili, me burim nga testamenti nr. ****, datë 13.12.2014, lëshuar nga vjehri i saj.

19.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm ka rezultuar se testamentlënësi ka shprehur vullnetin e tij për trashëgiminë/përfitimin e pasurisë me të dhënat e përshkruara më sipër vetëm për djalin e tij A. S., duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë nga kjo pasuri.

19.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar gjithashtu se në datën 22.1.2016 pasuria ka kaluar në bashkëpronësi të bashkëshortit A. S. dhe nënës së tij, si dhe është bërë rivlerësimi në vlerën 3.871.500 lekë, fakt i cili është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2016.

19.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se arsyeja e lëshimit të testamentit të babait të bashkëshortit për pjesën e tij të banesës, përveç vullnetit të testamentlënësit, ka qenë edhe fakti që bashkëshorti është djali i vetëm i familjes dhe se djali ka qenë ai që i ka shërbyer, pasi 2 vajzat janë larguar në emigrim prej më shumë se 20 vitesh.

19.5 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se vjeherri i subjektit e kishte blerë pasurinë në fjalë me anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.12.1995, nga pala shitëse M. dhe Xh. B., kundrejt çmimit 1.350.000 lekë. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 20.12.2016, të lëshuar nga ZVRPP Lushnjë (sot ASHK), e cila ka bërë me dije se në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit dhe familjes së tij të origjinës ka qenë një apartament me nr. pasurie ***, në Lushnjë, të cilin e kanë shitur me anë të kontratës nr. ***, datë 9.1.1996, në vlerën 900.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se pasuria në fjalë është përdorur prej saj duke filluar nga muaji nëntor 2003, pasi është martuar dhe në vijim.

19.6 E pyetur nga Komisioni në lidhje me mospërputhjen e vlerës 3.000.000 lekë të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 me vlerën e blerjes së apartamentit në fjalë prej 1.950.000 lekësh, referuar kontratës datë 20.12.1995, subjekti ka sqaruar se me vlerën 3.000.000 lekë ka konceptuar vlerën e tregut në atë vit në qytetin e Lushnjës, pra është një mënyrë deklarimi pa qëllim, për shkak të moskuptimit të drejtë të plotësimit të deklaratës.

19.7 Në këto kushte, në vlerësim përfundimtar të të gjitha provave dhe rrethanave të evidentuara dhe analizuara më sipër, lidhur me pasurinë apartament banimi në lagjen “****”, Lushnjë, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konkludon se subjekti ka kryer një deklaram të saktë në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk janë konstatuar problematika mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, për sa kohë ajo rrjedh nga testamenti i babait të bashkëshortit të subjektit dhe, për më tepër, kjo pasuri është krijuar nga babai i tij shumë vite përpara se subjekti të kishte lidhur martesë.

20. Automjet tip “Daimler Chrysler”

20.1 Kjo pasuri është deklaruar prej subjektit në DIPP-në e vitit 2012, e blerë me anë të kontratës së datës 9.8.2012, në vlerën 300.000 lekë dhe me burim nga shitja e automjetit para 3 viteve.

20.2 DPSHTRR-ja¹⁸ ka konfirmuar se në emër të shtetasve Merita dhe A. S. është i regjistruar automjeti tip “Daimler Chrysler”, me targë ***, prodhim i vitit 2002, i përfituar me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 9.8.2012, nga pala shitëse D. T., kundrejt çmimit 300.000 lekë.

20.3 Shitja e automjetit të mëparshëm është deklaruar prej subjektit në DIPP-në e vitit 2008, me përshkrimin “Lekë *cash* në shtëpi 500.000 nga shitja e automjetit Benz (dhjetor 2008)”.

¹⁸ Me shkresat nr. *** prot., datë 7.8.2017 dhe datë 29.8.2017.

20.4 Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se shitja e automjetit të mëparshëm nga bashkëshorti i subjektit, me anë të kontratës nr. ***, datë 24.12.2008, është bërë tek pala blerëse A. C., kundrejt çmimit 500.000 lekë. Ndërkohë, ky automjet ishte blerë më herët nga bashkëshorti i subjektit me anë të kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 28.6.2003, kundrejt çmimit 250.000 lekësh nga shtetasi Dh. K.

20.5 Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, nga Komisioni i është kërkuar subjektit të jepte shpjegimet e saj në lidhje me arsyet e shitjes së këtij automjeti me një çmim më të lartë se ai i blerjes, pas 5 vitesh përdorimi, si dhe të paraqiste dokumentacionin që provon pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga kjo shitje, si diferencë mes çmimit të shitjes dhe asaj të blerjes. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se nuk disponon dokumentacion mbi shërbime të mundshme të kryera për mjetin në fjalë, porse çmimet e përshkruara në kontratat përkatëse të shitblerjeve pasqyrojnë vullnetin dhe çmimin e dakordësuar mes palëve. Për sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore, ajo është shprehur se pagesa e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë është mbajtur dhe derdhur në buxhetin e shtetit, sipas ligjit nr. 8977, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mos paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar pagesën e detyrimit tatimor.

20.6 Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues çmon se referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, nuk parashikohet në mënyrë eksplicite pagesa e këtij detyrimi e, për rrjedhojë, nuk mund të rëndojë pozitën e subjektit për këtë çështje. Nisur nga fakti se subjekti nuk provoi me dokumentacion shërbimet e mundshme të kryera për mjetin në fjalë, Komisioni ka konsideruar në vitin 2008 si të ardhura me burim të ligjshëm vetëm shumën 250.000 lekë, të barabartë me çmimin e blerjes.

20.7 Nga shqyrtimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se ajo ka tërhequr nga llogaria e saj e pagës në datën 7.8.2012 (2 ditë përpara blerjes së mjetit) shumën 400.000 lekë, e cila duket e mjaftueshme për të përballuar blerjen e automjetit në analizë.

20.8 Përgjatë hetimit administrativ, referuar shkresës së DPSHTRR-së të cituar më sipër, të dhënave të sistemit TIMS, por edhe nga verifikimi i kryer nga Komisioni në sistemin informatik të AMF-së, subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë rezultuar pronarë apo përdorues të automjeteve të tjera, veç atij të deklaruar në pronësi. Subjekti dhe personat e lidhur kanë udhëtuar jashtë vendit me automjetin me targë ***, ndërsa për bashkëshortin ka rezultuar një kalim nga pika kufitare *** në datën 15.8.2017 me automjetin me targë ***.

20.9 DPSHTRR-ja¹⁹ ka bërë me dije se automjeti me targë *** nuk ka rezultuar i regjistruar në këtë institucion, si dhe është përcjellë dosja për automjetin me targë ***, i cili ka rezultuar në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k.

20.10 Në lidhje me shtetasit D. T., Dh. K., A. C. dhe shoqërinë “****” sh.p.k., si dhe shtetasin N. Gj., i cili sipas AMF-së ka rezultuar përdorues i këtij automjeti në periudhën kur është kryer udhëtimi në fjalë.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.2.2023.

20.11 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë²⁰ ka bërë me dije se ata nuk kanë rezultuar të kallëzuar, të dyshuar, persona nën hetim apo të pandehur në procedime penale të mosfilluara, të pushuara, të pezulluara apo të dërguara për gjykim nga kjo Prokurori.

20.12 SPAK-u²¹ ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të shtetasve të sipërpërmendur.

20.13 Nisur nga sa është përshkruar më lart, në vlerësimin përfundimtar të të gjitha provave dhe rrethanave të evidentuara dhe analizuara më sipër lidhur me pasurinë automjet tip “Daimler Chrysler”, trupi gjykues konkludon se subjekti ka kryer një deklaram të saktë në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk janë konstatuar problematika mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

21. Obligacione në vlerën 2.000.000 lekë

21.1 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar obligacionet në fjalë, në vlerën 2.000.000 lekë pranë Credins Bank, dega Lushnjë, me interes 6.4%, por pa deklaruar burimin e të ardhurave të përdorura për investimin e tyre. I njëjti deklaram është përsëritur edhe më pas në deklaratën *Vetting*, duke shtuar burimin nga kursimet e punës dhe të kredisë. Ndërkohë, në DIPP-në e vitit 2015 – të dorëzuar prej subjektit në datën 21.3.2016 – ajo ka bërë një shënim, në të cilin ka cituar: “*Cash-in në banesë e kam reduktuar; konkretisht më 3.2.2016 kam depozituar 2.000.000 lekë në Credins Bank për emetimin e letrave me vlerë, si dhe 2.000.000 lekë më 23.3.2016 në llogarinë rrjedhëse të pagës në BKT*”.

21.2 Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur një kontratë të lidhur në datën 3.2.2016 me Credins Bank, në cilësinë e ndërmjetësit, për kryerjen e veprimeve mbi emetimin e letrave me vlerë të qeverisë. Me anë të vërtetimit të datës 8.2.2016, Credins Bank ka bërë me dije se nga njoftimi i ardhur nga Banka e Shqipërisë, subjekti është shpallur fituese në ankandin e datës 4.2.2016, për blerjen e obligacioneve me vlerë nominale 2.000.000 lekë, me afat 5-vjeçar dhe me kupon 6-mujor.

21.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar se depozitimi në llogarinë e subjektit në Credins Bank është kryer në datën 3.2.2016, me përshkrimin “Derdhje për obligacione 5-vjeçare”.

21.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 – subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i krijimit të këtij depozitimi (si dhe depozitimit në BKT) rrjedh nga tërheqja e kryer prej saj në datën 31.7.2014, nga Credins Bank, të shumës 3.000.000 lekë, si dhe kursimeve të tjera të disponuara. Ndërkohë, nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2014 ka rezultuar se është deklaruar prej subjektit tërheqja e kësaj shume, por nuk është deklaruar prej saj përdorimi i këtyre fondeve apo mbartja e tyre në formën e kursimeve *cash* në banesë.

21.5 Po ashtu, sa i përket çeljes së depozitës prej 3.000.000 lekësh në Credins Bank, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar të jetë kryer në datën 21.3.2012. Në DIPP-në e këtij viti, subjekti nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të përdorura për këtë depozitim. Në shpjegimet e dhëna prej saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, si dhe në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në mars të vitit 2016 – subjekti ka bërë me dije se për depozitimin e shumës prej 3.000.000 lekësh në vitin 2012, ajo ka përdorur nga kursimet

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 24.2.2023.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.2.2023.

e disponuara *cash* në banesë nga vitet e mëparshme shumën prej 2.642.700 lekësh, si dhe një pjesë të kursimeve të vitit 2012. Ajo ka vijuar më pas shpjegimet se në vitin 2014, kur është tërhequr depozita në fjalë, është mbajtur në banesë në formën *cash* dhe është përdorur prej saj më pas për investimin në analizë, në vitin 2016.

21.6 Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se veprimet me depozitat në fjalë dhe ndryshimet në gjendjen e disponuar *cash* në banesë nuk janë deklaruar nga subjekti.

21.7 Nga analiza e kryer nga Komisioni, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e familjes për periudhën 1.1.2012 – 21.3.2012, për sa kohë nuk është deklaruar pakësimi i kursimeve *cash* në DIPP-në e vitit 2011, ka rezultuar një mungesë e burimeve financiare prej 2.952.768 lekësh, sikurse është detajuar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për depozitimin e shumës 3.000.000 lekë në vitin 2012

Të ardhura nga pagat 1.1.2012 – 21.3.2012	153,000
Shpenzime të familjes 1.1.2012 – 21.3.2012	(105,768)
Investuar në depozitë me afat 21.3.2012	(3,000,000)
Rezultati në datën 21.3.2012	(2,952,768)

21.8 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse, si dhe për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit, lidhur me: (i) Duket se subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi ka përshkruar si burim për krijimin e kësaj shume monetare të investuar në obligacione edhe të ardhurat e përfituara nga kredia bankare, ndërkohë që shuma e disbursuar nga kredia në fjalë ka pasur si destinacion të vetëm përdorimi blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit – sikurse është deklaruar prej saj dhe është konstatuar edhe nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni; (ii) Duket se për depozitimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2012, të shumës 3.000.000 lekë, ajo ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej -2.952.768 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me barrën e provës

21.9 Subjekti ka pretenduar se duke qenë se burim i krijimit të pasurive të saj kanë qenë vetëm të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit, si dhe kredia bankare, gabimisht ka vendosur si burim të krijimit të të gjitha pasurive edhe kredinë. Pavarësisht sa më sipër, subjekti ka pranuar pasaktësitë e paqëllimshme, duke saktësuar se burimi i kësaj pasurie janë kursimet ndër vite. Ajo ka shpjeguar se saktësimi i bërë përpara dorëzimit të deklaratës *Vetting* pranë organit kompetent (ILDKPKI-së) është një dokument që duhet të vlerësohet nga Komisioni njësoj si deklaratat e pasurisë dhe duhet të shërbejë për përlllogaritjen e gjendjes *cash*, duke cituar vendime të Kolegjit, nr. 20/2019, nr. 37/2021 etj.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

21.10 Shumica e trupit gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv)

shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

Lidhur me deklarinin e burimit të krijimit të shumës së investuar në datën 21.3.2012

21.11 Nga analizimi i deklarimeve të subjektit ndër vite, deklarimi sqarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, si dhe deklarimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, ka mospërputhje lidhur me burimin e saktë që ka shërbyer për krijimin e këtij investimi në vitin 2012, pasi: (i) në DPV-në e vitit 2012 dhe në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti deklaron si burim për këtë depozitë kursimet e punës dhe kredia, ndërkohë që në procesverbalin e ILDKPKI-së të muajit mars 2016 deklaron se si burim për krijimin e kësaj depozite kanë shërbyer kursimet nga gjendja *cash* në banesë dhe pakësimi i llogarive të pagave të vitit të mëparshëm; (ii) gjithashtu, subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2011 se kredia ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të vitit 2011, prej 53.687 euro, ndërkohë që në deklaratën *Vetting* 2017 dhe në DPV-në e vitit 2012 deklaron se si burim për krijimin e depozitës prej 2.000.000 lekësh kanë shërbyer kursimet dhe kredia. Pra, subjekti është e paqartë lidhur me burimin e krijimit të secilit aset, për rrjedhojë kredia nuk mund të ketë shërbyer për krijimin e të dyja asetëve, si apartamentit në vitin 2011, ashtu edhe krijimit të depozitës në vitin 2012.

21.12 Në këto kushte, deklarimi i subjektit nuk është i besueshëm lidhur me burimin e krijimit të këtyre asetëve dhe, për rrjedhojë, e vë Komisionin në pamundësi/vështirësi në drejtim të analizimit të burimit të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi.

21.13 Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar me vërtetësi burimin e krijimit të kësaj depozite, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting* 2017, pasaktësi e cila ndikon edhe në analizimin e burimit dhe mjaftueshmërinë e krijimit të pasurive apartament dhe depozitë së bashku.

Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të depozitës

21.14 Duke qenë se trupi gjykues e ka analizuar kredinë në funksion të pagesës së këstit të dytë të apartamentit, lidhur me krijimin e depozitës, do të analizojë si burim kursimet nga pagat e subjektit, sipas deklaratave periodike vjetore, të cilat, bazuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë. Këto deklarime marrin rëndësinë e provës kryesore në rastin e gjendjes së likuiditetit *cash*, duke qenë se nuk mund të provohen në mënyrë tjetër, përveç deklarimeve të subjektit në DPV, por edhe në rastin konkret të subjektit të rivlerësimit, në kushtet e pasaktësisë, trajtuar më lart.

21.15 Nga analizimi i deklaratave periodike vjetore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar ndryshime, shtime apo pakësime të gjendjes *cash*. Trupi gjykues vlerëson të theksojë se si subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së prej vitit 2003, mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve *cash*, nëse kjo kishte ndodhur në vitin respektiv. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: *“Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: [...] të çdolloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit”*. Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4,

shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, që parashikon: “[...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

21.16 Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit, përveçse ka deklaruar jo saktësisht burimet, gjithashtu nuk ka qenë e saktë në mënyrën e deklarimit të gjendjes së likuiditeteve *cash*, pasi rezultoi herë e deklaruar si gjendje e herë si shtesë. Përveç sa sipër, subjekti nuk ka deklaruar në DPV zvogëlimet e gjendjes së likuiditetit *cash*, zvogëlim i cili sipas subjektit ka shërbyer për krijimin e pasurisë objekt analizimi.

21.17 Në këto kushte, trupi gjykues, nisur edhe nga jurisprudenca e Kolegjit²², “Kolegji ka mbajtur qëndrim të konsoliduar tashmë, se gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara kësaj gjendjeje nuk mund të provohen ndryshe në këtë proces, përveçse me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie që mund ta provojë atë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e depozitimit të kryer në datën 21.3.2012 të shumës 3.000.000 lekë, në një vlerë prej -2.952.768 lekësh.

21.18 Si konkluzion të sa më lart, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

22. Llogari rrjedhëse në BKT, në vlerën 2.810.633 lekë

22.1 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogarinë rrjedhëse pranë BKT Lushnjë, në vlerën 2.772.346 lekë, me burim nga kursimet e punës dhe të kredisë, duke shënuar se 2.000.000 lekë janë derdhur nga kursimet *cash* ndër vite dhe një pjesë kredisë, si dhe 701.964 lekë kursime nga të ardhurat e pagës së vitit 2016.

22.2 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë llogari me gjendje 2.810.633 lekë, me burim nga kursimet e punës dhe të kredisë.

22.3 Në DIPP-në e vitit 2015 – të dorëzuar në datën 21.3.2016 – subjekti ka bërë një shënim, në të cilin ka cituar: “*Cash-in në banesë e kam reduktuar, konkretisht më 3.2.2016 kam depozituar 2.000.000 lekë në Credins Bank, për emetimin e letrave me vlerë, si dhe 2.000.000 lekë më 23.3.2016 në llogarinë rrjedhëse të pagës në BKT*”.

22.4 Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të pagës ka rezultuar se prej subjektit është kryer depozitimi në *cash* i shumës 2.000.000 lekë, në datën 23.3.2016. Ndërsa, pjesa tjetër ka rezultuar të jetë akumuluar në llogari, me burim nga kreditimi i pagave.

22.5 E pyetur nga Komisioni mbi këtë investim – në përgjigje të pyetësorit nr. 2 – subjekti i rivlerësimit është shprehur se burimi i krijimit të këtij depozitimi (si dhe atij të trajtuar më lart në këtë vendim) rrjedh nga tërheqja e kryer prej saj në datën 31.7.2014, nga Credins Bank, të shumës prej 3.000.000 lekësh, si dhe kursimeve të tjera të disponuara. Ndërkohë, nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2014, ka rezultuar se është deklaruar prej subjektit tërheqja e kësaj shume,

²² Vendim nr. 31/2021 (JR), datë 12.10.2021, në të cilin janë cituar vendimet: vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.4.2019; paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 5.4.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 8.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.1.2020, paragrafi 50; vendim nr. 11/2019 (JR), paragrafi 27; vendim nr. 19/2019 (JR), paragrafët 84-85.

por nuk është deklaruar prej saj përdorimi i këtyre fondeve apo mbartja e tyre në formën e kursimeve *cash* në banesë.

22.6 Në vijim të analizës së kryer në trajtimin e pasurisë (pika 21, obligacionet), për sa kohë nuk është deklaruar dhe konsideruar pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2012 për krijimin e kësaj pasurie – burimet alternative rezultojnë të pamjaftueshme për investimin e shumës 2.000.000 lekë në obligacione, në vitin 2016.

22.7 Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të dhënë shpjegime bindëse, si dhe për të paraqitur dokumentacionin ligjor për të provuar të kundërtën e rezultateve të Komisionit, lidhur me sa vijon:

22.7.1 Duket se subjekti ka kryer një deklaram të pasaktë në deklaratën *Vetting*, pasi ka përshkruar si burim për krijimin e kësaj shume monetare të investuar në obligacione edhe të ardhurat e përfituara nga kredia bankare, ndërkohë që shuma e disbursuar nga kredia në fjalë ka pasur si destinacion të vetëm përdorimi blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit – sikurse është deklaruar prej saj dhe është konstatuar edhe nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni.

22.7.2 Duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e gjendjes në llogarinë pranë BKT-së – duke rezultuar kështu një bilanc negativ prej **-2.810.633** lekësh për krijimin e kësaj vlere monetare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

22.8 Subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime sikurse edhe në lidhje me obligacionet, duke shtuar se për shkak të pasaktësisë së mosdeklarimit të pakësimit të gjendjes *cash* në vitin 2012, balanca negative e përlllogaritur nga Komisioni është në shumën -2.008.676, lekë ndërsa në vitin 2014, për shkak të mosdeklarimit të gjendjes *cash* të tërhequr nga depozita, balanca pozitive është në shumën 3.787.625 lekë. Pra, dy vitet të cilat analiza financiare duket anormale janë pikërisht vitet që kanë të bëjnë me pasaktësitë në DPV-të lidhur me gjendjen *cash*, pasaktësi të ndrequra pranë organit kompetent, jashtë procesit të rivlerësimit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

22.9 Shumica e trupit gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaramet periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaramet në seancë dëgjimore – arsyeton se:

Lidhur me deklaramin e burimit të krijimit të llogarisë rrjedhëse në vitin 2016

22.10 Nga analizimi i DPV-së së vitit 2016, si dhe deklaramet e subjektit gjatë hetimit administrativ, ka mospërputhje lidhur me burimin e saktë që ka shërbyer për krijimin e kësaj llogarie rrjedhëse, pasi subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2016 se ka llogari rrjedhëse pranë BKT-së Lushnjë, në vlerën 2.772.346 lekë, me burim nga kursimet e punës dhe të kredisë, duke shënuar se 2.000.000 lekë janë derdhur nga kursimet *cash* ndër vite dhe një pjesë kredie, si dhe 701.964 lekë kursime nga të ardhurat e pagës së vitit 2016,

ndërkohë që në DPV-në e vitit 2011 ka deklaruar se kredia ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të vitit 2011 prej 53.687 euro, për apartamentin në Tiranë. Pra, subjekti është e pasaktë/paqartë lidhur me deklarin e burimit të krijimit të secilit aset, e cila duket se vjen si rrjedhojë e faktit se kredia nuk mund të ketë shërbyer për krijimin e të dyja aseteve, si apartamentit në vitin 2011, ashtu edhe krijimit të depozitës në vitin 2016.

22.11 Në këto kushte, deklarimi i subjektit nuk është i besueshëm lidhur me burimin e krijimit të këtyre aseteve dhe, për rrjedhojë, e vë Komisionin në pamundësi në mënyrë të përsëritur në drejtim të analizimit të burimit të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi.

22.12 Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar me vërtetësi burimin e krijimit të kësaj depozite, duke u gjendur në kushtet e deklarinimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratën *Vetting* 2017, pasaktësi e cila ndikon edhe në analizimin e burimit të mjaftueshëm të krijimit të pasurive apartament dhe depozitë, së bashku.

Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të depozitës

22.13 Duke qenë se trupi gjykues e ka analizuar kredinë në funksion të pagesës së këstit të dytë të apartamentit, lidhur me krijimin e depozitës, do të analizojë si burim kursimet nga pagat e subjektit, sipas deklaratave periodike vjetore, të cilat bazuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 mund të përdoren si provë. Këto deklarime marrin rëndësinë e provës kryesore në rastin e gjendjes së likuiditetit *cash*, duke qenë se nuk mund të provohen në mënyrë tjetër, përveç deklarinimeve të subjektit në DPV, ku në rastin konkret subjekti i rivlerësimit ka deklaruar jo me vërtetësi burimet e krijimit dhe gjendjen e likuiditeteve *cash*, trajtuar më lart.

22.14 Nga analizimi i DPV-së së vitit 2014, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar ndryshime, shtime apo pakësime të gjendjes *cash*. Trupi gjykues vlerëson të theksojë se si subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së prej vitit 2003, mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte çdo ndryshim të mundshëm të gjendjes së kursimeve *cash*, nëse kjo kishte ndodhur në vitin respektiv. Në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, kërkohet nga deklaruesit: *“Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: [...] të çdolloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarinimit”*. Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, që parashikon: *“[...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”*.

22.15 Në rastin e subjektit, nuk provohet nga DPV-të e viteve 2014 dhe 2015 që ajo të ketë deklaruar gjendje të likuiditetit *cash* në banesë vlerën 3.000.000 lekë, përfituar nga mbyllja e depozitës në Credins Bank në vitin 2014. Në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* në banesë për vitet 2014 dhe 2015, nuk kishte se çfarë të pakësonte në vitin 2016 për krijimin e llogarisë pranë BKT-së. Për rrjedhojë, subjekti nuk provon se ka pasur gjendje *cash* në banesë në shumën 2.000.000 lekë për krijimin e llogarisë rrjedhëse në vitin 2016.

22.16 Në këto kushte, trupi gjykues, nisur edhe nga jurisprudenca e Kolegjit²³, “Kolegji ka mbajtur qëndrim të konsoliduar tashmë, se gjendja e likuiditeteve cash apo kursimet e shtuara kësaj gjendjeje nuk mund të provohen ndryshe në këtë proces, përveçse me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie që mund ta provojë atë”, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e depozitimit të kryer në vitin 2016, në vlerën prej -2.810.633 lekësh.

Si konkluzion të sa më lart, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj llogarie rrjedhëse në vitin 2016.

23. Lidhur me aksione në letra me vlerë tek shoqëria “**” sh.p.k.**

23.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar aksione letër me vlerë të vitit 1996, tek shoqëria “****” sh.p.k., në shumën 400.000 lekë, të cilat janë blerë në vlerën 10.000 lekë. Këto aksione ishin deklaruar prej subjektit në DIPP-në e vitit 2003. Subjekti ka deklaruar 500 letra me vlerë, në vlerën 100.000 lekë, nga shoqëria “****” Durrës, me burim nga kursimet nga paga.

23.2 E pyetur nga Komisioni mbi këto letra me vlerë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se nuk ka blerë letra me vlerë pranë shoqërisë “****” sh.p.k., por ka depozituar pranë kësaj shoqërie. Ajo ka shtuar se nuk ka përfutur asnjë interes nga investimi i tyre, pasi shoqëria ushtroi aktivitetet për një kohë të shkurtër dhe nuk ka marrë as vlerën e depozituar. Së bashku me përgjigjet e mësipërme, subjekti ka paraqitur një certifikatë anëtarësie pranë shoqërisë “****”, nga ku është konstatuar se në datën 17.10.1996 është depozituar prej subjektit shuma nominale prej 405.000 lekësh, e cila është blerë prej saj në vlerën 10.000 lekë.

23.3 Subjekti ka paraqitur gjithashtu: formularin *online*, që vërteton falimentin e kësaj shoqërie; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.7.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka bërë me dije se dokumentacioni i zyrës së regjistrimit tregtar është transferuar pranë QKB-së; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.7.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, se nga viti 2007 e në vijim nuk ka pasur çështje gjyqësore apo procedura për likuidim të kësaj shoqërie; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.7.2021, nga Banka e Shqipërisë, se fondet e investimit nuk kanë qenë subjekt licencimi dhe mbikëqyrjeje nga Banka e Shqipërisë e, për rrjedhojë, nuk disponon informacion; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.7.2021, nga QKB-ja, se nga të dhënat e transferuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka rezultuar se me vendimin nr. ***, datë 6.5.1996, është regjistruar shoqëria “****”, por nuk ka të dhëna për NIPT nga organet tatimore.

23.4 Nga sa më sipër, për sa kohë prej subjektit nuk është pretenduar përfitimi i interesave apo kthimi pas i shumës së investuar, si dhe nuk ka rezultuar përdorimi i tyre si burim për krijimin e ndonjë prej pasurive të subjektit, Komisioni nuk shikon arsye për të vijuar më tej me hetimin për këto letra me vlerë.

23.5 Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie – përpos mospërputhjes së vlerave të deklaruara.

²³ Vendim nr. 31/2021 (JR), datë 12.10.2021, në të cilin janë cituar vendimet: vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.4.2019; paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 5.4.2019, paragrafi 32.5; vendim nr. 29/2019 (JR), datë 8.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.1.2020, paragrafi 50; vendim nr. 11/2019 (JR), paragrafi 27; vendim nr. 19/2019 (JR), paragrafët 84-85.

24. Depozitë në Union Bank në emër të bashkëshortit, në vlerën 150.000 lekë

24.1 Në deklaratën e personit të lidhur në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar një depozitë në Union Bank, në vlerën 150.000 lekë, me burim nga dëshmia e trashëgimisë së babait të tij, z. S. S. dhe depozitës së këtij të fundit pranë së njëjtës bankë.

24.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, ka rezultuar se vjehri i subjektit ka pasur gjendje në llogarinë e tij të depozitës pranë Union Bank, shumë prej 328.455 lekësh, e cila në datën 11.12.2015 është transferuar përkatësisht në llogaritë e secilit prej trashëgimtarëve të shtetasit S. S., me nga 82.113,82 lekë/secili, me përshkrimin sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. ***.

24.3 Në po të njëjtën datë, 11.12.2015, tre trashëgimtarët e tjerë, N. S., E. S. dhe G. C., kanë kaluar pjesën e tyre në llogarinë e bashkëshortit të subjektit.

24.4 Ndonëse është konfirmuar ligjshmëria e burimit të krijimit të gjendjes së llogarisë në fjalë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nuk është e qartë arsyeja e transferimit të shumave nga trashëgimtarët e tjerë, të pjesës së tyre takuese.

24.5 Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të gjendjes së llogarisë.

25. Llogari në Raiffeisen Bank në emër të bashkëshortit, në vlerën 48.602 lekë

25.1 Në deklaratën e personit të lidhur në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar një llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank, në vlerën 48.602 lekë.

25.2 Nga shqyrtimi i lëvizjeve të kësaj llogarie është konfirmuar se gjendja e mësipërme është krijuar nga të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të subjektit.

25.3 Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të gjendjes së llogarisë në analizë.

26. Depozitë në emër të vajzës M. S., në shumën 994.218 lekë

26.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitën bankare në emër të vajzës së saj pranë Raiffeisen Bank, në shumën 994.218 lekë, e krijuar prej vitit 2011 në emër të subjektit e më pas transferuar në vitin 2013 në emër të vajzës M. S.

26.2 Nga shqyrtimi i llogarive bankare ka rezultuar se kjo depozitë është investuar fillimisht nga subjekti në datën 14.9.2007, në shumën 400.000 lekë, e depozituar *cash* prej saj. Në vijim, kjo depozitë është shtuar me të ardhurat nga interesat ndër vite, si dhe me veprimet e mëposhtme: (i) transferuar 150.289 lekë në datën 15.12.2008 nga llogaria e pagës; (ii) transferuar 120.000 lekë në datën 29.12.2009 nga llogaria e pagës; (iii) depozituar *cash* 120.000 lekë në datën 15.2.2012; (iv) depozituar *cash* 120.000 lekë në datën 21.3.2013.

26.3 Më pas, në datën 18.4.2013, subjekti i rivlerësimit ka kaluar vlerën e akumuluar në depozitën e mësipërme prej 1.208.846 lekësh në llogarinë e vajzës së saj. Në këtë llogari, subjekti ka shtuar në datën 19.6.2014 shumën prej 120.000 lekësh, të depozituar *cash* prej saj dhe në datën 1.12.2016 ka tërhequr shumën prej 500.000 lekësh, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2016, *cash* në banesë, duke mbetur llogaria me gjendjen e deklaruar prej subjektit në deklaratën *Vetting*.

26.4 Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të subjektit mbi këtë depozitë ka rezultuar se nuk është deklaruar prej saj transferimi në llogari të vajzës në DIPP-në e vitit 2013, ndonëse janë deklaruar prej saj shtesat mbi këtë depozitë në vitet 2013 dhe 2014. Lidhur me mosdeklarimin e depozitës në emër të vajzës në DIPP-në e vitit 2013, subjekti është shprehur se bëhet fjalë për një pasaktësi nga ana e saj, për sa kohë prej saj janë deklaruar shtesat në vijim.

26.5 Nga analiza financiare është konkluduar se për çeljen në vitin 2007 të kësaj depozite, si dhe për shtesat në vijim, subjekti ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare.

26.6 Nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave për çeljen e kësaj depozite dhe shtesave të kryera ndër vite në të.

27. ANALIZA FINANCIARE

27.1 Komisioni ka kryer analizën financiare mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

27.2 Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së, deri në vitin 2016, nga ku, sikurse është detajuar në tabelat e mëposhtme, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ prej -3.125.179 lekësh.

27.3 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës më sipër, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet se:

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

27.4 Në prapësimet e dërguara pas njoftimit të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar ndryshimin e rezultatit të analizës financiare të përlllogaritur nga Komisioni, nga -3.125.179 lekë në -396.998 lekë, duke pretenduar përfshirjen në analizë të të ardhurave si më poshtë vijon:

- i) kursimet e realizuara deri në vitin 1992, në shumën 4.000 USD;
- ii) të ardhurat nga qiraja të vëllait të subjektit në periudhën 1996 – 1998;
- iii) gjendjen *cash* në banesë, sipas shpjegimeve të detajuara të dhëna prej saj në ILDKPKI në vitin 2016.

27.5 Subjekti ka pretenduar se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit²⁴ diferenca e sipërcituar, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

27.6 Në vijim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në prapësimet e saj, të trajtuara më sipër përgjatë trajtimit të pasurive në këtë vendim, ka rezultuar se për periudhën 2003 – 2016 subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e

²⁴ Vendimi nr. 2/2023.

pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, konkretisht në datën 30.07.2003 në vlerën 1.163.429 lekë; në datën 21.03.2012 në vlerën 2.952.768 lekë; në datën 23.03.2016 në vlerën 2.810.633 lekë.

27.7 Në përfundim, trupi gjykues – bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, situatë e cila, krahas problematikave të tjera të konstatuara në deklaratimet në vite të subjektit, ndonëse jo të cituara në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 33, pika 5 e të ligjit nr. 84/2016, çojnë në përfundimin se subjekti ka dështuar të provojë bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në këto kushte, subjekti gjendet para situatës së parashikuar prej pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 e, për pasojë, duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLI I FIGURËS

28. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit – pa përgjigjen e njërit prej organeve verifikuese/ligjzbatuese – me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, për vijimin e detyrës.

29. Me shkresën e datës 5.6.2018, pranë Komisionit është përcjellë informacion shtesë i klasifikuar lidhur me dyshime mbi veprimtari të kundërligjshme të subjektit, të shfaqura në formën e ndërveprimit korruptiv, në raport me disa çështje penale.

30. Në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim të raportit në fjalë nga ish-DSIK (aktualisht AKSIK), me shkresën e datës 23.9.2022 ka përcjellë pranë Komisionit një tjetër raport, me nr. *** prot., datë 29.8.2022. Më tej, ky raport është deklasifikuar pjesërisht, në datën 19.9.2022 nga organi kompetent, me vendimin nr. *** të KDZH-së.

31. Nga analiza e informacioneve të përcjella nga organet ligjzbatuese, Komisioni ka kryer disa hapa hetimorë për njohjen më në detaj të elementeve dyshuese, të fakteve dhe rrethanave që ndërthureshin me veprimtarinë profesionale të subjektit, me qëllim verifikimin e prezencës ose jo të elementeve që mund të konfirmonin dyshimet e ngritura.

32. Në vlerësim të të dhënave që disponoheshin lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, nisur nga informacionet e përcjella nga organet verifikuese dhe pasi janë aksesuar informacionet e klasifikuara pranë organit ligjzbatues, në përputhje me nenin 41, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim administrativ gjithëpërfshirës, duke kërkuar informacione dhe dokumentacione shtesë. Gjithashtu janë administruar dhe analizuar disa akte, vendime e dosje, që lidheshin me çështjet penale, me qëllim verifikimin e të dhënave të raportuara të bëra me dije edhe nëpërmjet aksesimit të dokumenteve e informacioneve të klasifikuara, që lidheshin me kriterin e figurës.

33. Lidhur me sa më sipër, nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 12.5.2023, Komisioni iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lushnjë dhe me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, iu drejtua Gjykatës së Shkallës së Parë të

Juridiksionit të Përgjithshëm Fier. Këto institucione kanë përcjellë²⁵ pranë Komisionit dokumentacionin përkatës të kërkuar, nga analizimi i të cilit ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Në lidhje me procedimin/çështjen penale, me të dyshuar shtetasin R. D.

34. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka përcjellë aktet e dosjes penale nr. *** dhe vendimin nr. *** (***), datë 21.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

35. Nga shqyrtim i tyre ka rezultuar se në datën 28.3.2013, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka regjistruar procedimi penal nr. 83, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit R. D., i cili ushtronte detyrën e oficerit të policisë gjyqësore pranë Komisarariatit të Policisë Lushnjë. Kallëzimi është bërë nga shtetasi M. P., i cili ka pretenduar se shtetasi R. D. nuk ka kryer veprimet e nevojshme lidhur me kallëzimin e bërë prej tij për një vjedhje.

36. Nga aktet ka rezultuar se me urdhrin nr. 83, datë 28.3.2013, prokurorja Merita Selimi, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ka urdhëruar “Regjistrimin e procedimit penal nr. ***, për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; hetimi do të ndiqet nga prokurorja R. (B.) Z.; të regjistrohet në regjistrin e njoftimit të veprave penale emri i personit nën hetim, R. D.”.

37. Në vijim, me kërkesën e datës 28.6.2013, prokurorja R. Z. i ka kërkuar Gjykatës caktimin e masës së sigurimit personal me karakter ndalues “Pezullimi i ushtrimit të një detyre shtetërore” ndaj personit nën hetim R. D.. Më vendimin nr. *** (***), datë 16.7.2013, Gjykata rrëzoi kërkesën e Prokurorisë, duke arsyetuar ndër të tjera se vërtetohet se ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se shtetasi R. D. mund të ketë kryer veprën penale që i atribuohet nga organi i akuzës, por në referencë të paragrafit 3 të nenit 228, nuk ka një bazë të mjaftueshme të dhënash se i dyshuari do të mund të përsërisë veprën apo të kryejë krime të tjera ose do të mund të largohet, duke mos vendosur masë sigurie.

38. Prokuroria e ka ankimuar vendimin e mësipërm, por ndërkohë Gjykata, me vendimin nr. *** (***), datë 21.1.2014, ka vendosur të pushojë çështjen, duke arsyetuar ndër të tjera se Gjykatës i është krijuar bindja se jemi në rrethanat e një shkeljeje administrative të kryer si pasojë e neglizhencës së treguar nga i pandehuri R. D. në ushtrimin e detyrës, fakt i cili duhet të shqyrtohet nga strukturat përkatëse të institucionit ku ai ishte i punësuar. Sipas Gjykatës, organi i akuzës nuk arriti të provonte ardhjen e ndonjë pasoje konkrete si pasojë e mosveprimit të tij.

39. Në datën 30.1.2014, Prokuroria ka paraqitur apel ndaj vendimit nr. *** (***), datë 21.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Pas ankimimit nga prokurorja Z., Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 18.12.2014, ka vendosur lënien në fuqi të pushimit të mësipërm, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

40. Në vijim, pas rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 19.2.2016, ka vendosur mospranimin e këtij rekursi.

41. Në përfundim, lidhur me sa është parashtruar më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, në raport me rastin konkret, nuk është përfshirë as në veprime hetimore dhe as

²⁵ Gjykata me shkresën nr. *** prot., datë 16.5.2022 dhe Prokuroria me shkresën nr. *** prot., datë 24.5.2022.

ka marrë vendime lidhur me këtë procedim penal. Ajo, në cilësinë e drejtueses, ka nxjerrë vetëm urdhrin për regjistrimin e procedimit penal dhe ka shqyrtuar një kërkesë të paraqitur nga i pandehuri për zëvendësimin e prokurores së çështjes – kërkesë të cilën nuk e ka pranuar²⁶ – si dhe ka kryer detyra të tjera të natyrës administrative, siç është edhe nënshkrimi i shkresave përcjellëse, për shkak të detyrës funksionale që ushtronte si drejtuese e Prokurorisë. Kësisoj, nuk ka rezultuar që subjekti të jetë përfshirë në veprimet hetimore të procedimit penal nr. *** dhe, për pasojë, as nuk është evidentuar ndonjë shkelje apo parregullsi e veprimtarisë së saj profesionale.

42. Në këto kushte, Komisioni nuk mund të kryejë hetime dhe vlerësime të mëtejshme lidhur me informacionin e klasifikuar, për sa kohë nga dokumentacioni i administruar nuk rezultoi ndonjë përfshirje apo lidhje e subjektit me faktet e dyshuara/përshkruara në to.

Në lidhje me procedimin/çështjen penale, me të dyshuar shtetasin Ristan Janko

43. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 16.5.2022, ka bërë me dije se nga verifikimet e kryera në sistemin CCMIS të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk ka rezultuar që në ngarkim të këtij shtetasi të ketë pasur ndonjë procedim penal apo të jetë zhvilluar ndonjë gjykim penal në emër të tij, për periudhën nga viti 2007 e në vijim.

44. Ndërsa, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka përcjellë dokumentacionin, ku ka rezultuar edhe vendimi i datës 18.5.2014, për pushimin e procedimit penal nr. ***, i marrë nga prokurori P. Ç., si dhe shkresat përcjellëse për njoftimin e këtij vendimi, të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi. Në këto kushte, Komisioni e ka përsëritur kërkesën, duke kërkuar të gjithë dosjen penale lidhur me çështjen në fjalë.

45. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se në datën 20.2.2014 Komisariati i Policisë Lushnjë i ka përcjellë Prokurorisë materialet procedurale në ngarkim të shtetasit R. J.

46. Në datën 21.2.2014, prokurori P. Ç. ka nxjerrë një vendim për kontroll banese. Po në këtë datë, i njëjti prokuror i ka kërkuar Gjykatës vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit për shtetasin R. J. Gjykata, me vendimin nr. *** (***) datë 23.2.2014, e ka vlerësuar të ligjshëm arrestimin në flagrancë dhe ka vendosur masën e sigurimit “detyrim paraqitje”. Përfaqësuese e prokurorisë në këtë seancë ka qenë subjekti i rivlerësimit Merita Selimi.

47. Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 23.2.2014, bazuar në aktin e ekspertimit nga i cili ishin konfirmuar kushtet e ekzistencës së veprës penale “plagosje e rëndë me dashje” ka vendosur pranimin e kërkesës dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim paraqitje”.

48. Në datën 18.5.2014, prokurori P. Ç., duke arsyetuar se nisur nga fakti se personi i dëmtuar ka tërhequr ankimin, si dhe duke marrë në konsideratë se kjo është nga ato vepra që ndiqen me ankesë të të dëmtuarit, prokurori i çështjes (z. Ç.) ka vendosur pushimin e çështjes në fjalë.

49. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Prokuroria, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e përfaqësueses së Prokurorisë në seancën

²⁶ Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar ka rezultuar se i pandehuri, duke mos qenë dakord me vendimin e Drejtueses së Prokurorisë Lushnjë, znj. Selimi, ka paraqitur edhe një kërkesë në Prokurorinë e Përgjithshme për zëvendësimin e prokurores, por edhe Prokurori i Përgjithshëm nuk e ka pranuar kërkesën e tij. Me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2023.

e vleftësimit të ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimit të masës së sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, kërkesa të cilat janë pranuar nga Gjykata. Ndërsa veprimet hetimore janë kryer nga një tjetër prokuror.

50. Në vijim të analizimit të vendimit të pushimit të çështjes – ndonëse nuk është marrë nga subjekti, por nga një tjetër prokuror – ka rezultuar i bazuar në nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale, ku një ndër rastet e pushimit të çështjes është edhe parashikimi në shkronjën “c” të këtij neni, ku përcaktohet se: *“c) i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij”*.

51. Në përfundim të analizimit të dokumentacionit të administruar dhe nga të dhënat e tjera të disponuara nga Komisioni është konkluduar se nuk janë evidentuar shkelje procedurale, veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, që mund të ngrenë dyshime mbi favorizimin e mundshëm të personit të dyshuar. Edhe në rolin e drejtueses së institucionit të Prokurorisë, subjekti duket se ka përmbushur detyrën e saj, duke njoftuar palët përkatëse me vendimmarrjen në rastin konkret dhe, gjithsesi, pa asnjë rol vendimmarrës në raport me këtë procedim penal.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të figurës

52. Në përfundim, nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë e përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ajo ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk ka bërë deklaramë të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

53. KLP-ja ka përcjellë raportin, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, mbi të cilin është kryer rivlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

54. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

55. Raporti i përcjellë nga KLP-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

56. Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, si dhe të dhënave në arkivin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, prej datës 20.5.2013 deri në datën 7.1.2016 ka qenë me detyrën e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Gjatë 3 viteve, 2014 – 2016, ka trajtuar gjithsej 621 materiale, nga këto 402 procedime penale dhe 219 kallëzime penale. Ka përfunduar gjithsej 592 materiale, nga këto 375 procedime penale dhe 217 kallëzime penale. Për vitin 2017 ka mbartur 27 procedime penale dhe 2 kallëzime penale.

57. Znj. Selimi ka deklaruar se për vitet 2015 dhe 2016 ka qenë e ngarkuar me detyrën e prokurorit në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe me hetimin dhe përfaqësimin e akuzës në gjykatë. Për vitin 2015 ka përgatitur 766 urdhra ekzekutimi dhe 102 urdhra për vitin 2016.

58. Znj. Merita Selimi, për periudhën 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, ka trajtuar gjithsej 509 çështje, nga të cilat 106 çështje të dërguara për gjykim, 54 çështje të pushuara, 199 çështje të mosfilluara dhe 145 çështje të pezulluara.

59. Ndaj subjektit Merita Selimi nuk është dhënë asnjë masë disiplinore, por ka rezultuar një kërkesë nga shtetasi E. L., i cili ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit kishte nënshkruar një vendim mosfillimi, në cilësinë e drejtueses së kësaj prokurorie, ndërkohë që ishte shkarkuar nga detyra. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë është bërë sqarimi përkatës në lidhje me këtë kërkesë.

60. Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, nuk ka rezultuar i regjistruar asnjë kallëzim penal ndaj prokurores Merita Selimi.

61. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak të dokumentuar, ku të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

62. Komisioni, pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, përgjithësisht nuk vërejtí problematika të natyrës procedurale dhe as mangësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

63. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin përkatës bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe nga organet e tjera ligjzbatuese, si dhe ka analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

64. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni, përgjithësisht për sa i përket tre dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, nuk ka konstatuar problematika apo shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

65. Përgjatë hetimit administrativ Komisioni ka administruar vendimet e gjykatës të dhëna në lidhje me 3 dokumentet e analizuar nga KLP-ja. Nga shqyrtimi i këtyre vendimeve, Komisioni ka konstatuar se në dy nga çështjet që i përkasin dokumentet në analizë, subjekti ka kërkuar kalimin e çështjes në gjykatë dhe deklarimin fajtor të të pandehurit, kërkesa të cilat janë pranuar nga gjykata. Në të dyja rastet gjykata nuk është shprehur në lidhje me mangësi apo hetimet të paplota nga ana e prokurores. Ndërsa në një rast subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e procedimit penal dhe ky vendim nuk është ankimuar.

66. Konkretisht, në lidhje me kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2015, që i përket dokumentit nr. 1, të analizuar nga KLP-ja, me anë të së cilës subjekti ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit D. H. dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim, ka rezultuar se Gjykata me vendimin nr. ***, datë 14.10.2015, ka vendosur dënimin e tij me 30 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal, uljen me 1/3 dhe dënimin e tij me 20 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehuri dhe Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur dënimin e tij (në aplikim të nenit 406/1 të Kodit Penal) dënimin e tij me 16 vjet e 8 muaj.

67. Në lidhje me vendimin e pushimit të procedimit penal ndaj shtetasit Xh. S., që i përket dokumentit nr. 2, të analizuar nga KLP-ja, ky vendim nuk ka rezultuar i ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

68. Në lidhje me vendimin për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, që i përket dokumentit nr. 3, të analizuar nga KLP-ja, me anë të së cilit subjekti ka kërkuar deklarimin fajtor të të pandehurit J. K. dhe dënimin e tij me gjobë në vlerën 210.000 lekë, ka rezultuar se Gjykata me vendimin nr. ***, datë 1.11.2016, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit J. K. dhe dënimin e tij me 180.000 lekë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 11.11.2016.

69. Për sa i përket 5 dosjeve të analizuar nga KLP-ja, sikurse është konkluduar edhe nga ky institucion, nuk janë evidentuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit.

70. Komisioni ka shqyrtuar gjithashtu edhe dokumentacionin në lidhje me konstatimin e KLP-së në raportin e tij, ku bëhej fjalë për kërkesën e shtetasit E. L., drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Kërkuesi pretendonte se znj. Merita Selimi kishte nënshkruar një vendim mosfillimi, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë, ndërkohë që ishte shkarkuar nga detyra. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se shtetasi E. L. ka paraqitur edhe një ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë lidhur me vendimin nr. ***, datë 27.11.2014, të prokurorit A. H., për mosfillimin e procedimit penal. Ndër të tjera, ankuesi ka pretenduar se vendimi i sipërcituar është nënshkruar (miratuar) nga znj. Selimi, në datën 13.1.2015, ndërkohë që, sipas tij, në këtë datë ajo nuk ka qenë në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë.

71. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se me urdhrin nr. ***, datë 7.1.2015, është vendosur lirimi i znj. Merita Selimi nga detyra e drejtuesit të Prokurorisë. Me urdhrin nr. ***, datë 7.1.2015, është bërë komandimi në këtë detyrë i prokurorit A. D.

72. Gjatë procesit gjyqësor gjykata i ka lënë detyrë prokurorit të paraqesë kopje të vendimit të lirimimit nga detyra e drejtuesit të Prokurorisë të znj. Selimi dhe emërimin në vend të saj të prokurorit A. D. Më tej, në seancën e datës 15.7.2015, prokurori ka paraqitur urdhrin e datës 7.1.2015 dhe është shprehur se ky urdhër ka mbërritur në Prokurori në datën 8.1.2015, si dhe

ka sqaruar se dosja, pjesë e së cilës ishte edhe vendimi objekt gjykimi, kishte përfunduar në datën 27.11.2014. Sipas tij, shkresa përcjellëse e nënshkruar nga znj. Selimi nuk ndikonte në vlefshmërinë e aktit.

73. Përgjatë hetimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka përcjellë shkresat përcjellëse për njoftimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 13.1.2015, drejtuar shtetasve T. B. dhe E. L.

74. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime në lidhje pretendimet e ngritura në ankimin e sipërpërshkruar.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

75. Subjekti është shprehur se ka firmosur shkresat deri në datën kur ka qenë në detyrë si drejtuese. Nga ngarkesa e fundvitit e sekretarisë, shkresat janë protokolluar në datën 13.1.2015 (vonesa ka qenë rreth 3 ditë, duke pasur parasysh që data 8.1.2015 ka qenë ditë e enjte dhe shkresat janë protokolluar ditën e martë). Pretendimet e shtetasit E. L. janë verifikuar nga Prokuroria e Përgjithshme, ku është marrë informacion nga ish-Prokuroria e Rrethit Lushnjë. Për të vërtetuar këtë praktikë të organizimit të punës, subjekti ka kërkuar të pyetet si deklaruese ish-kryesekretarja e Prokurorisë, E. Z, për procedurën e ndjekur në rastin në fjalë.

Vlerësimi i trupit gjykues

76. Pas shqyrtimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e saj rezultojnë bindëse dhe se gjithsesi, me sa të dhëna janë disponuar, nuk mundësohet përcaktimi i momentit të protokollimit të shkresave në fjalë. Megjithatë, në çdo rast vërehet se fakti i konstatuar lidhet me veprimtarinë administrative të saj si drejtuese e institucionit dhe jo me atë profesionale.

DENONCIME

77. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Merita Selimi janë paraqitur 11 denoncime nga publiku. Nga këto denoncime, 2 prej tyre kanë rezultuar të përsëritura, ndërsa 1 prej tyre nuk i referohej subjektit të rivlerësimit. Të gjitha denoncimet janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, nga shqyrtimi i denoncimeve që janë paraqitur nga publiku ka rezultuar si vijon:

77.1 Denoncim nr. * prot., datë 24.1.2022, i shtetasit A. Ç.**

Denoncuesi ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur hetimin lidhur me procedimin penal nr. ***, për veprën penale “neglizhenca në trajtimin mjekësor”, parashikuar nga neni 96/2 i Kodit Penal dhe nuk ka dhënë asnjë informacion lidhur me të.

Në vendimin nr. ***, datë 5.5.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë²⁷ ka vlerësuar se kërkesa e Prokurorisë për kalimin e çështjes në gjyq i plotësonte elementet formale dhe ato procedurale, në përputhje me nenet 331 dhe 327 të Kodit të Procedurës Penale, për njoftimin për përfundimin e hetimeve, ndryshe nga sa ka pretenduar denoncuesi.

Në lidhje me pretendimin e denoncuesit për zvarritje të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka bërë me dije se referimi penal është regjistruar në këtë

²⁷ Administruar nga Komisioni gjatë hetimit, me të njëjtën shkresë.

Prokurori në datën 24.9.2019. Më pas, pasi janë kryer veprimet hetimore përkatëse, me urdhrin e datës 29.10.2019 është bërë regjistrimi i emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale. Në vijim, me kërkesën e datës 30.12.2020, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq. Sikurse konstatohet nga aktet e sipërpërshkruara, hetimi nga Prokuroria është zhvilluar në harkun kohor rreth 3 muaj. Referuar paragrafit 2 të nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, “Afati i përfundimit të hetimeve është tre muaj nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale”.

Çështja në fjalë është kthyer për hetim nga Gjykata, me qëllim kryerjen e detyrave shtesë të lëna prej saj. Me vendimin e datës 26.11.2021, subjekti, në funksion të hetimit të detyrave të lëna nga Gjykata, ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit nga data 26.11.2021 deri më 26.2.2022, duke njoftuar edhe personin nën hetim dhe të dëmtuarin, si dhe duke ju bërë me dije atyre të drejtën për të paraqitur ankim.

Me vendimin e datës 26.2.2022, subjekti, për shkak të ngarkesës së madhe të hetimit gjatë vitit 2021 (duke qenë se kishte mungesa prokurorësh), ka vendosur zgjatjen e afateve të hetimit deri në datën 26.5.2022. Ndonëse në vendimin e zgjatjes parashtrohet *të njoftohet personi nën hetim dhe i dëmtuari, duke ju bërë me dije atyre të drejtën për të paraqitur ankim*, nga aktet nuk ka rezultuar ndonjë njoftim i tyre lidhur me këtë vendim.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, është konstatuar se njoftimi i shtetasit A. Ç. mbi ecurinë e hetimit penal është bërë me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2022, në përgjigje të kërkesës së bërë prej tij. Në këtë shkresë është sqaruar se për shkak të ngarkesës së punës në këtë Prokurori nuk është bërë e mundur kryerja e hetimit brenda një kohe të shkurtër.

Me anë të kërkesës së datës 17.5.2022, subjekti i rivlerësimit, ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq, duke njoftuar edhe personin nën hetim dhe të dëmtuarin, me shkresat nr. *** prot. dhe nr. *** prot., datë 18.5.2022²⁸. Vendimi i përfundimit të hetimit i është komunikuar palëve.

Gjatë hetimit Komisioni ka kërkuar në mënyrë të përsëritur të administrojë kopje të njoftimit të palëve lidhur me zgjatjen e afateve të hetimi, por nga Prokuroria është vënë në dispozicion vetëm 1 njoftim për zgjatje afati, ndërkohë që kanë rezultuar 4 vendime për zgjatje afati të hetimeve.

Në përfundim të shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit të përshkruar më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqes shpjegime lidhur me pretendimin e palës për mosnjoftim mbi ecurinë e hetimit, duke paraqitur dokumente provuese.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka parashtuar se për shkak të ngarkesës në punë nuk është arritur të respektohet afati 2-mujor i hetimit i përcaktuar nga gjykata. Ajo ka sqaruar se në datën 28.5.2021 efektivisht në punë kanë qenë vetëm tre prokurorë, duke përfshirë edhe drejtuesin. Ajo është shprehur se ka qenë e caktuar si prokurorë e seksionit të të miturve, ndërkohë që ishte e caktuar edhe prokurorë për seksionin e ekzekutimeve të vendimeve të formës së prerë. Në muajin korrik, për periudha të gjata ka qenë edhe prokurorja e vetme efektivisht në punë, pasi dy prokurorët e tjerë kanë qenë me raport mjekësor dhe leje të zakonshme (edhe kjo për shkaqe shëndetësore). Gjithashtu, subjekti ka parashtuar se në periudhën korrik – 24.9.2021 ka ushtruar edhe funksionin e

²⁸ Me shkresat nr. *** prot. dhe nr. *** prot., nr. *** prot., datë 18.5.2022.

drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për shkak të mungesës dhe më pas shkarkimit nga Komisioni të drejtuesit të Prokurorisë në atë kohë. Për shkak të situatës së krijuar, subjekti ka shprehur se është detyruar t'u japë përparësi çështjeve me persona nën hetim që ishin me masën e sigurisë “arrest në burg”, për të mos u ezauruar afatet e paraburgimit, seancave gjyqësore të vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masave të sigurimit, si dhe përfaqësimit në gjykim, në mënyrë që Prokuroria të mos bëhej shkak për zvarritje të gjykimit. Konkretisht, në periudhën 2011 – 2022, subjekti ka deklaruar se ka pasur: 692 procedime penale dhe kallëzime penale në hetim, nga të cilat ka përfunduar 472 procedime e kallëzime; 276 çështje themeli të përfaqësuara në gjykim; 161 përfaqësime në çështje me ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë; 87 përfaqësime në gjykim të çështjeve penale-administrative dhe masa mjekësore; 46 përfaqësime mase sigurimi; 519 urdhra ekzekutimi; 13 letërporosi, ekstradime. Duke qenë në rolin e zëvendësdrejtueses edhe pas komandimit të drejtuesit, ajo ka bërë me dije se ka qenë e angazhuar në kryerjen e funksioneve të ndryshme administrative. Mbi bazë të ankesës së shtetasit A. Ç. është filluar hetim disiplinor nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, ku pas një hetimi të gjatë dhe të hollësishëm është pushuar hetimi disiplinor, duke vlerësuar ngarkesën e prokurorit gjatë periudhës së hetimit të këtij procedimi penal dhe konstatimit se nga prokurori në çështjet që janë marrë në shqyrtim me persona nën hetim me masë sigurie “arrest në burg” janë respektuar afatet e hetimit, si dhe janë respektuar dispozitat e nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale për njoftimin e palëve, duke theksuar se ky ishte një rast sporadik. Bashkëlidhur vë në dispozicion vendimmarrjen e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, ku është analizuar veprimtaria e magjistratit për këtë periudhë.

Subjekti ka bërë gjithashtu me dije se pavarësisht kalimit të afatit 2-mujor të caktuar nga gjykata është respektuar përfundimi i hetimeve brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 324/2 i Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka ardhur asnjë pasojë në kuptim të ushtrimit të ndjekjes penale dhe vënies së autorëve para përgjegjësisë. Thekson se respektimi i afateve të hetimit dhe respektimi i dispozitës së nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale është konstatuar edhe nga ana e Komisionit në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit gjatë kontrollit të çështjeve penale që i janë nënshtruar vlerësimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

Pas analizimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se është evident fakti se subjekti ka pasur një ngarkesë të lartë sasiore sa i përket procedimeve penale të ndjekura dhe hetuara prej saj, sikurse është konfirmuar edhe nga burimet arkivore të trajtuara në raportin e KLP-së. Megjithatë, trupi gjykues çmon se në rastin konkret, për sa kohë nuk janë evidentuar shkelje të të drejtave procedurale, të parikuperueshme, të tilla si humbja e afateve të ankimit, mosnjoftimi i palëve për zgjatjen e afateve të hetimit, si dhe mosrespektimi i afatit 2-mujor i hetimit i përcaktuar nga gjykata, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit.

77.2 Denoncimet nr. * prot., datë 29.11.2017 dhe nr. *** prot., datë 14.11.2017, të shtetasit L. B.**

Denoncuesi në të dyja denoncimet e paraqitura prej tij ka parashtruar se vendimi i datës 15.6.2017, për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, të regjistruar në datën 8.5.2017, lidhur me veprimet arbitrare të ZRPPP-së ndaj pronës së tij, ka qenë i padrejtë. Ai kishte paraqitur një kallëzim penal, ku pretendonte se një aktmarrëveshje për pjesëtim pasurie dhe një prokurë,

të dyja të vitit 2000, të falsifikuara, ishin shkak i dhënies së një akti pronësie të padrejtë nga ZVRPP-ja Lushnjë.

Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka marrë në pyetje kallëzuesin, duke i kërkuar të bënte me dije nëse aktet objekt kallëzimi ishin përdorur ose jo në institucione apo procese të tjera. Pas deklarimit të tij se ato nuk ishin përdorur më parë, bazuar në nenin 66 të Kodit Penal, nenin 290, pika 1, shkronja “e” dhe nenin 291, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar ndër të tjera se edhe nëse nga kryerja e veprimeve hetimore do të provoheshin pretendimet e kallëzuesit (falsifikimi i akteve objekt kallëzimi), përsëri nuk do të regjistrohej procedim penal në ngarkim të noterit i cili i kishte përpiluar ato, për shkak se në referim të periudhës së prezumimit të kryerjes së veprës penale “shpërdorimi i detyrës”, përsëri instituti i parashkrimit nuk do të lejonte regjistrimin e procedimit penal. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2017, kallëzuesit i është komunikuar vendimi i mosfillimit të procedimit penal.

Komisioni, bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet, ka konstatuar se pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara.

77.3 Denoncim nr. * prot., datë 9.3.2022, i shtetases A. G.**

Denoncuesja ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur çështjen lidhur me kallëzimin e bërë prej saj ndaj shtetasit V. N., si dhe se nuk është informuar lidhur me çështjen. Për këtë çështje, denoncuesja ka bërë denoncim edhe në emisionin “****”, në datën 16.5.2022.

Nga aktet e administruara ka rezultuar se prokurorja N. P., në datën 30.7.2020, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, me kallëzuese shtetasen A. Gj. ndaj bashkëshortit të saj, të kallëzuarit V. N., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “ngacmim seksual”, e kryer ndaj fëmijës së mitur, parashikuar nga neni 108/2 i Kodit Penal. Në datën 25.5.2021, drejtuesi i Prokurorisë ka marrë vendim për zëvendësimin e prokurores për shkak të lejes së lindjes, me subjektin e rivlerësimit M. Selimi. Më pas është paraqitur një tjetër kallëzim me shkresën nr. ***, datë 26.8.2021, të Komisarariatit të Policisë Lushnjë nga shtetasi V. N. ndaj bashkëshortes A. Gj., me nr. ***, për veprën penale “dhuna në familje”, e kryer ndaj të miturit, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin e datës 31.12.2021, lidhur me kallëzimin penal në fjalë, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 31.12.2021. Po në këtë datë, subjekti ka vendosur bashkimin e procedimeve nr. *** dhe nr. ***, të përshkruara më sipër, në një të vetëm me nr. ***.

Në vijim, subjekti, me urdhrin e datës 17.5.2022, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, të shtetases A. Gj. ndaj shtetasit V. N., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “vepra të turpshme”, parashikuar nga neni 108/1 i Kodit Penal.

Duke qenë se shtetasi A. Gj. dhe V. N. kishin bërë disa kallëzime ndaj njëri-tjetrit, subjekti ka vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. *** dhe nr. ***, për një hetim më të plotë. Gjithashtu, ajo ka vendosur bashkimin e procedimeve nr. *** (bashkuar me procedimin nr. ***) dhe procedimin penal nr. ***, në një të vetëm, atë me nr. ***.

²⁹ [https://www.youtube.com/***\)](https://www.youtube.com/***))

Më pas, me kërkesën e datës 27.9.2022, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë pushimin e çështjes penale nr. ***.

Në përfundim të analizimit të provave dhe veprimeve hetimore të kryera, subjekti ka arritur në përfundimin se fakti penal i parashikuar nga neni 108/1 i Kodit Penal nuk ekziston. Në këto kushte, ajo i ka kërkuar gjykatës pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** (bashkuar me procedimet penale nr. *** dhe nr. ***). Me shkresën nr. *** prot., datë 5.10.2022, shtetasja A. Gj. i është komunikuar kërkesa për pushimin e çështjes.

Në datën 2.2.2022, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, sipas kallëzimit të paraqitur nga shtetasja A. Gj. ndaj shtetasit V. N.

Në datën 17.5.2022, subjekti ka regjistruar procedimin penal nr. 310, për veprën penale “përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal, sipas kallëzimit të paraqitur nga shtetasja A. Gj. ndaj shtetasit V. N.

Me vendimin e datës 18.5.2022, subjekti ka vendosur bashkimin e procedimeve nr. ***, për veprën penale “përndjekja”, parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal dhe atë me nr. ***, për të njëjtën vepër penale, në një të vetëm, atë me nr. ***. Nga aktet ka rezultuar se në kallëzimin në fjalë shtetasja A. Gj. ka pretenduar se bashkëjetuesja e ish-bashkëshortit të saj e përndiqte. Subjekti i rivlerësimit ka kryer veprimet hetimore lidhur me çështjen, ka marrë në pyetje shtetasit në fjalë, si dhe ka administruar edhe prova nga dosja e procedimit penal nr. ***, të trajtuar më sipër dhe në përfundim, në datën 5.9.2022 ka vendosur pushimin e procedimit pena. Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2022, kallëzueses i është komunikuar kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. ***.

Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur me afatet e hetimit të çështjes objekt denoncimi, si dhe njoftimin e palëve në raport me procedurën e përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka sqaruar se në çështjen në fjalë nuk ka pasur të regjistruar person nën hetim dhe çështjet penale janë dërguar në gjykatë me kërkesë për pushim, pra prokurori ka zbatuar procedurën në çështjet penale të mësipërme, është respektuar parashikimi i nenit 329/a, pikat 1 dhe 4, ku parashikohet: “...*kërkesa i njoftohet ...viktimit ose trashëgimtarëve të saj..., si dhe personit që ka bërë kallëzimin ose ankimin. Ata kanë të drejtën të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre*”. Njoftimi i kallëzueses është bërë sipas parashikimeve të nenit 329/a/4 Kodit të Procedurës Penale.

Vlerësimi i trupit gjykues

Trupi gjykues, pasi analizoi prapësimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se fakti që nuk ka pasur person nën hetim kushtëzon edhe afatin 2-vjeçar të hetimit të përcaktuar në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, lidhur me çështjet penale objekt denoncimi, subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesë për pushim, në respektim të parashikimit të nenit 329/a, pikat 1 dhe 4, ku përcaktohet se: “...*kërkesa i njoftohet ...viktimit ose trashëgimtarëve të saj..., si dhe personit që ka bërë kallëzimin ose ankimin. Ata kanë të drejtën të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre*”.

Në shpjegimet e saj, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar se njoftimi i kallëzueses është bërë sipas parashikimeve të nenit 329/a/4 Kodit të Procedurës Penale.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk konstatohen shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me hetimin e çështjes në fjalë.

77.4 Denoncim nr. * prot., datë 29.12.2017, i shtetasit A. Rr.**

Në denoncimin e tij, shtetasi A. Rr. ka paraqitur ankesa ndaj 19 prokurorëve dhe gjyqtarëve, mes tyre edhe ndaj prokurores Merita Selimi, duke pretenduar se ndaj tij janë dhënë vendime të padrejta, për mungesë të aftësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, të përfshirë në korrupsion. Denoncuesi nuk ka paraqitur dokumentacion përkatës, për të dokumentuar pretendimet e tij, për rrjedhojë, ato mbeten në nivel deklarativ.

Gjithashtu, ai nuk i është referuar ndonjë rrethane konkrete dhe nuk ka përshkruar ndonjë fakt apo shkelje procedurale të bërë nga subjekti i rivlerësimit dhe as nuk ka paraqitur ndonjë provë kundër saj. Për sa më sipër, duket se denoncimi nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” e, për pasojë, nuk mund të merret në konsideratë nga Komisioni.

77.5 Denoncim nr. * prot., datë 16.4.2019, i shtetas V. H.**

Denoncuesja ka pretenduar njëanshmëri moskryerje hetimesh dhe mbylljen e hetimit me vendimin për mosfillimin e procedimit penal nga prokurorja Merita Selimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit ka rezultuar se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në datën 18.7.2016 ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, të paraqitur nga shtetasja V. H., në ngarkim të shtetasit G. K., për veprën penale “mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimit, me vendimin e datës 12.10.2016, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me referimin e veprës penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, datë 18.7.2016, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. ***, datë 17.2.2017, ka vlerësuar se nga Prokuroria janë kryet të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, konform ligjit dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga shtetasja V. H., si të pambështetur në ligj.

Nga sa më sipër, duket se nuk janë evidentuar *indicie* që mund të ngarkonin subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale.

77.6 Denoncim nr. * prot., datë 20.6.2019, i shtetasit E. T.**

Denoncuesi ka parashtruar se në procedimin penal nr. ***, datë 18.7.2016, prokurorja M. Selimi ka kërkuar deklarimin fajtor të tij, për veprën penale “vjedhje”, parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Sipas tij, vendimi është dhënë në kundërshtim me ligjin dhe me provat, si dhe duke ndryshuar deklaratimet e dëshmitarëve.

Në vijim, me vendimin nr. ***, datë 22.8.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vlerësuar se nga prokuroria është provuar tërësisht dhe jashtë çdo dyshimi fajësia e të pandehurit, si dhe e ka gjetur të drejtë dhe të bazuar akuzën dhe llojin dhe masën e dënimit të kërkuar nga prokuroria.

³⁰ Administruar nga Komisioni gjatë hetimit me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2022. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2023.

Nga sa më sipër, sikurse ka rezultuar edhe nga vendimmarrja e gjykatës, në cilësinë e organit që vlerëson ligjshmërinë e verimeve hetimore të organit të akuzës, duket se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi në hetime nga ana e subjektit të rivlerësimit.

77.7 Denoncim nr. * prot., datë 27.7.2021, i shtetasit A. H.**

Denoncuesi ka pretenduar se me kërkesën e datës 19.7.2021, drejtuar prokurores Merita Selimi, ka kërkuar të informohet në lidhje me procedimin penal me nr. ***, datë 29.12.2020. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 22.7.2021, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë e ka sqaruar shtetasin A. H. lidhur me sa ai ka kërkuar të informohet, duke i sqaruar edhe afatet procedurale përkatëse në lidhje me kohëzgjatjen e hetimeve.

Komisioni ka administruar dokumentacionin nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, nga i cili ka rezultuar se procedimi penal nr. ***, viti 2020, me kallëzues shtetasin A. Gj., ka përfunduar. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka kërkuar pushimin e këtij procedimi dhe me vendimin nr. ***, datë 20.12.2021, është pranuar kërkesa e prokurorisë për pushimin e procedimit penal.

Në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 14.4.2021, Prokuroria ka bërë me dije se ky kallëzim është bashkuar me atë me nr. *** të vitit 2021. Sipas përgjigjes së datës 23.1.2023, çështja vijon të jetë ende në fazën e hetimeve paraprake në ndjekje të prokurores M. Selimi.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se regjistrimi i datës 29.12.2020, për kallëzimin e bërë nga shtetasi A. H., është bërë nga një tjetër prokurore (N. P.), e cila është zëvendësuar me pas me vendimin e datës 26.2.2021, për shkak të lejes së lindjes, nga prokuroja M. Selimi. Në datën 17.1.2022, subjekti ka paraqitur një kërkesë për zëvendësimin e saj për shkak të ngarkesës, me prokuroren e cila e kishte pasur më parë çështjen në fjalë, meqenëse kjo e fundit ishte kthyer nga leja e lindjes. Në vijim, me vendimin nr. ***, datë 21.1.2022, drejtuesi i Prokurorisë ka vendosur zëvendësimin e prokurores M. Selimi me prokuroren N. P.

Në përfundim është evidentuar se subjekti i rivlerësimit, për një periudhë rreth 10-mujore – deri në momentin kur çështja i ka kaluar sërish prokurores që ka regjistruar fillimisht procedimin penal – nuk ka kryer asnjë veprim hetimor.

Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime lidhur procedurat dhe afatet hetimore të çështjes objekt hetimi, të hetuar prej saj.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka parashtruar se gjatë periudhës rreth 10-mujore – deri në momentin kur çështja në fjalë i ka kaluar sërish prokurores që ka regjistruar fillimisht këtë procedim penal – ajo ka ndjekur në dinamikë edhe çështje të tjera hetimore, të cilat kanë qenë për lloje veprash penale të rënda që kërkonin hetime komplekse e me shtrirje në kohë, kryerjen e ekspertimeve të ndryshme kimike, mjekoligjore, kriminalistike etj. Subjekti është shprehur se sipas saj përparësi kanë pasur çështjet me persona nën hetim me masën e sigurisë së arrestit në burg, për të mos përfunduar afatet e paraburgimit, pjesëmarrja në seancat gjyqësore të vleftësimit të arrestit dhe caktimit të masave të sigurimit, si dhe përfaqësimi në gjykim për të mos shkaktuar zvarritje të gjykimit. Subjekti e ka argumentuar ngarkesën e saj edhe në lidhje me vakancat e krijuara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Vlerësimi i trupit gjykues

Pas analizimit të prapësimeve të paraqitura nga subjekti, Komisioni vlerëson se ndonëse ngarkesa e pretenduar nga subjekti, si dhe e konfirmuar edhe nga burimet arkivore të KLP-së, ka qenë shkak i mosrespektimit të afateve të hetimit nga ana e subjektit të rivlerësimit, ky fakt nuk zbeh rëndësinë e afateve për të cilat ligji ka përcaktuar me rigorozitet kohëzgjatjen përkatëse. Megjithatë, në raste të veçanta, jurisprudenca ka legjitimuar zgjatjen e afateve brenda “një afati të arsyeshëm” në rastet e çështjeve komplekse. Konkretisht, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin nr. 26/2017 ka theksuar se: *“...arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që sjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit”*. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë pranon në vendimin e saj nr. 39, datë 9.12.2021, se mekanizmi i mishëruar në nenet 399/1 - 399/2 të Kodit të Procedurës Civile: *“...mund të jetë efektiv në rrethana të zakonshme të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor”*.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se, ndonëse mbetet problematika e mosrespektimit të afateve, duke mbajtur në vëmendje mbingarkesën dhe mangësitë në organikën e organit procedues, kjo rrethanë në vetvete nuk mjafton për të passjellë penalizim të subjektit lidhur me aftësitë profesionale.

77.8 Denoncimet nr. * prot., datë 25.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 8.11.2021, të shtetasit S. Sh.**

Denoncuesi, ndër të tjera, ka akuzuar edhe prokuroren Merita Selimi, duke pretenduar se ajo ka kryer një hetim të paligjshëm, arbitrar dhe tendencioz, për shkak se ka hetuar në kushtet e gjësë së gjykuar sipas vendimit nr. ***, datë 2.10.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Sipas denoncuesit, prokurorja Selimi ka mbajtur në hetim çështjen për 22 muaj dhe gjatë kësaj kohe e ka thirrur vetëm një herë. Ky fakt i pretenduar nga denoncuesi ka rezultuar i bërë publik prej tij edhe në emisionin “***”³¹.

Komisioni ka administruar dokumentacionin objekt denoncimi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga verifikimi i tij ka rezultuar se me urdhrin e datës 11.2.2022, prokurorja Selimi ka regjistruar procedimin penal nr. ***, ndaj shtetasit S. Sh., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Me urdhrin e datës 21.5.2022, pas kryerjes së hetimeve përkatëse, prokurorja ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale. Me shkresën nr. *** prot., datë 16.6.2022, është bërë njoftimi i kallëzuesit për përfundimin e hetimeve. Në vijim, në datën 30.6.2022, prokurorja M. Selimi ka njoftuar përfundimin e hetimeve dhe ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq.

Më pas, me vendimin nr. ***, datë 29.9.2022³², Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka vlerësuar se organi i akuzës ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe ka kryer hetime të plota në kuadër të grumbullimit të provave për të provuar faktin penal në ngarkim të të pandehurit S. Sh. Gjithashtu, Gjykata ka parashtruar në këtë vendim se prokurorja ka respektuar përcaktimet e neneve 324 dhe nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me

³¹ https://top-channel.tv/****/ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2023.

³² Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2022.

afatet dhe procedurën e njoftimit të palëve për përfundimin e hetimeve, si dhe është provuar marrja dijani e tyre përmes nënshkrimit në aktin e njoftimit. Pikërisht nëpërmjet aktit “Njoftim për përfundimin e hetimeve”, palëve iu mundësohet e drejta për të parashtruar pretendime lidhur me hetimin apo për të paraqitur kërkesa për hetime shtesë brenda 10 ditëve nga marrja dijani për përfundimin e hetimeve, që në rastin konkret nuk ka rezultuar që palët të kenë paraqitur ndonjë pretendim lidhur me veprimet hetimore të kryera për çështjen objekt hetimi.

Gjithashtu, Komisioni ka konstatuar se në këtë vendim gjykata është shprehur se vetë i pandehuri ka deklaruar në seancë se nuk ka pasur asnjë pretendim në lidhje me pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave. Gjykata e ka konsideruar të drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e prokurores Merita Selimi, duke e pranuar atë dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në gjykatë.

Për sa i përket pretendimit të denoncuesit, për zvarritje të hetimeve, sikurse ka arsyetuar edhe gjykata në vendimmarrjen e saj, përmes së cilës janë ligjësuar veprimet hetimore, nga ana e prokurores janë respektuar përcaktimet e nenit 324 lidhur me afatet e përfundimit të hetimeve paraprahe.

Për sa më sipër, duket se pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar të pabazuara, për rrjedhojë denoncimi nuk mund të mbahet në konsideratë në vlerësimin e kriterit profesional për subjektin e rivlerësimit Merita Selimi.

77.9 Denoncim nr. * prot., datë 7.12.2018, i shtetasit Gj. Ll.**

Në denoncimin e tij, shtetasi Gj. Ll. ka cituar emrin e një gjyqtari, një prokurori, si dhe prokuroren Merita Selimi. Në formularin e denoncimit ai ka shënuar “zvarritje të hetimit”, por nuk ka parashtruar ndonjë pretendim apo fakt në lidhje me gjyqtarin apo prokuroret e cituar në këtë formular.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni ka konstatuar se denoncuesi nuk ka paraqitur ndonjë provë konkrete/urdhër apo vendim të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe as nuk ka referuar ndonjë shkelje procedurale të kryer prej saj.

Për sa më sipër, denoncimi nuk përmbush kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokuroreëve në Republikën e Shqipërisë”, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

78. Subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, vlerëson se ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

79. Trupi gjykues, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi:

Në lidhje me kriterin e pasurisë, ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e shkronjës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti

i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e AKSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve apo hetime të paplota apo të pakryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Merita Selimi, vlerëson se ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues vlerëson se sjelljet e subjektit në drejtim të: (i) shmangies nga zbatimi i normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare në kundërshtim me etikën e magjistratit; (ii) problematikave mbi vërtetësinë e mjaftueshmërinë e deklarimeve të burimeve të pasurive të krijuara (apartament, obligacione e likuiditete *cash*), si dhe destinacionin e tyre – çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklaramet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me burimin e krijimit të pasurive të saj. Këto rrethana, në raport edhe me aspektet e tjera të kontrollit të kriterit pasuror, çmohen nga trupi gjykues se duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata, të cilat ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pikat 5 dhe 4 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikave 3 e 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Merita Selimi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 27.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ

Relator/Kundër

Etleda ÇIFTJA

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Gledis Hajdini